



USHTRIA



Viti i 74-të i botimit Nr. 10 (827708)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 5 Mars 2021

Konferencë: Komanda e Forcave Tokësore Amerikane për Europën dhe Afrikën



Gjeneralmajor Begaj: Porti i Durrësit dhe baza e Kuçovës pjesë e stërvitjes "Defender 21"

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH Gjeneralmajor Bajram Begaj mori pjesë në 1 mars 2021, në video-konferencën mbi Komunikimin Strategjik, në kuadër të përgatitjes për stërvitjen "Defender 21", konferencë e organizuar nën drejtimin e Komandës së Forcave Tokësore Amerikane për Europën dhe Afrikën.

Në konferencë morën pjesë personel i nivelit të lartë ushtarak i Komandës së SHBA-së në Europë, strukturave të NATO-s, si dhe vendeve anëtare dhe partnere pjesëmarrëse në stërvitjen Defender 21, ku u trajtuan çështje që lidhen me kontekstin strategjik që përshkon stërvitjen, planin e...

» faqe 2

Mesazh urimi me rastin e 8 marsit

"Për ju koleget e mia që shërbeni në Forcat e Armatosura"

Gjeneral Brigade Manushaqe Shehu, Zëvendës Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura



» faqe 4

Në Bazën Ajrore të Farkës Filloi Kursi Bazë i Oficerit në specialitetin Pilot Ushtarak Helikopteri

Kursi Bazë i Oficerit në specialitetin Pilot Ushtarak Helikopteri zgjat 49 javë mësimore-praktike dhe ndahet në dy faza: përgatitja Speciale-Helikopteri dhe Praktika Profesionale. Pjesë e kursit janë 12 kadetë, mes të cilëve edhe një vajzë » faqe 3



Intervistë me majore Enkelejda Tyrku

Rëndësia e profesionit: Ta duash atë dhe të japësh më të mirën nga vetja

Majore Enkelejda Tyrku është pedagoge në AFA, e cila spikat me korrektësinë, përkushtimin dhe angazhimin maksimal në stafin akademik, gjë që e bën figurën e saj si ushtarake, grua dhe nënë, të respektuar dhe vlerësuar që nga koha kur ka veshur mbi supet uniformën e ushtarakes. Majore Enkelejda ka ndjekur studimet në Universitetin e Tiranës në Fakultetin e Histori-Filologjisë...



» faqe 5

Modernizimi i Forcave të Armatosura

Ushtria Amerikane dhuron 29 mjete "Humvee" për Forcat e Armatosura

Ushtria e SHBA-së i ka dhuruar Forcave të Armatosura të Shqipërisë 29 automjete, të njohura si "Humvee". Lajmin e ka bërë me dije Ambasada e SHBA-ve në vendin tonë javën që kaloi, ditën e enjte, më 25 shkurt 2021, duke shtuar se këto mjete dhe do të ndihmojnë në rritjen e gatishmërisë ushtarake shqiptare dhe ndërveprimit të saj me NATO-n. "Njëzet..." » faqe 6



Një krizë shëndetësore të mos kthehet në një krizë sigurie

Stoltenberg në KE: NATO dhe BE duhet të bëjnë më shumë së bashku

» faqe 8

GJENERALMAJOR BEGAJ-GJENERALMAJOR HAZROLI

FA-FSK: Bashkëpunimi mes strukturave të inteligjencës ushtarake

» faqe 2

BOTIMI

Gjeneralletenant Spiro Moisiu në 250 faqet e një libri

» faqe 14

Konferencë: Komanda e Forcave Tokësore Amerikane për Europën dhe Afrikën

Gjeneralmajor Begaj: Porti i Durrësit dhe baza e Kuçovës pjesë e stërvitjes "Defender 21"

Stërvitja "Defender 21", e drejtuar nga SHBA, do të jetë një ndër stërvitjet më të mëdha të Aleancës për vitin 2021 dhe do të zhvillohet në territorin e 14 vendeve të Europës

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH gjeneralmajor Bajram Begaj mori pjesë në 1 mars 2021, në video-konferencën mbi Komunikimin Strategjik, në kuadër të përgatitjes për stërvitjen "Defender 21", konferencë e organizuar nën drejtimin e Komandës së Forcave Tokësore Amerikane për Europën dhe Afrikën.

Në konferencë morën pjesë personeli i nivelit të lartë ushtarak i Komandës së SHBA-së në Europë, strukturave të NATO-s, si dhe vendeve anëtare dhe partnere pjesëmarrëse në stërvitjen Defender 21, ku u trajtuan çështje që lidhen me kontekstin strategjik që përshkon stërvitjen, planin e komunikimit gjatë elementëve të stërvitjes, si dhe strategjinë për menaxhimin e keqinformimit të mundshëm.

Në fjalën e tij gjatë konferencës, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj theksoi se stërvitja "Defender 21" do të jetë një platformë ideale jo vetëm për të testuar kapacitetet ushtarake të vendit tonë, por gjithashtu do të mbartë një mesazh të qartë të mbështetjes së aleatëve strategjikë në përmbushjen e detyrimeve kushtetuese të FARSH.

Gjeneral Begaj theksoi se duke qenë të përgjegjshëm për rolin strategjik të Shqipërisë në rajon, vlerëson përfshirjen e portit të Durrësit dhe bazës ajrore të Kuçovës si infrastrukturë kritike në skenarin e stërvitjes. Gjithashtu, me prioritet do të jetë zbatimi i një protokollit të përbashkët i masave anti-COVID për të gjitha trupat pjesëmarrëse në stërvitje, duke përcjellë kështu mesazhe të unifikuar për përballimin e pandemisë.

Stërvitja "Defender 21" e drejtuar nga SHBA do të jetë një ndër stërvitjet më të mëdha të Aleancës për vitin 2021 dhe do të zhvillohet në territorin e 14 vendeve të Europës.



GJENERALMAJOR BAJRAM BEGAJ-GJENERALMAJOR GËZIM HAZROLLI

FA-FSK: Bashkëpunimi mes strukturave të inteligjencës ushtarake

SHSHPFJA Gjeneralmajor Bajram Begaj priti gjeneralmajorin Gëzim Hazrolli, drejtorin Inteligjencës dhe Sigurisë të Forcës së Sigurisë së Kosovës

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH gjeneralmajor Bajram Begaj priti më 26 shkurt, në një takim, drejtorin e Inteligjencës dhe Sigurisë të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Gjatë takimit me drejtorin e Inteligjencës dhe Sigurisë të Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjeneralmajor Hazrollin, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Bajram Begaj, vlerësoi bashkëpunimin e deritanishëm me Forcën e Sigurisë së Kosovës. Nga ana e tij, gjeneralmajor Hazrolli pasi e falënderoi gjeneralmajor Begajn për punën e mirë të bërë deri më tani si shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, shprehu gatishmërinë e tij për të vijuar bashkëpunimin e shkëlqyer të deritanishëm mes strukturave.

Gjatë takimit Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë gjeneralmajor Bajram Begaj, shprehu angazhimin e tij për vijimin e bashkëpunimit mes strukturave të inteligjencës ushtarake



të dy vendeve duke inkurajuar punën e mirë që mund të bëhet për të intensifikuar këtë bashkëpunim. Të dy bashkëbiseduesit gjatë takimit ndanë të njëjtat qasje për situatën e sigurisë në rajon, rolin e NATO-s si dhe vijimin e bashkëpunimit mes Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës edhe në të ardhmen. Takimi u zhvillua në kuadër të bashkëpunimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë me Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Në Bazën Ajrore të Farkës

Filloi Kursi Bazë i Oficerit në specialitetin Pilot Ushtarak Helikopteri

Kursi Bazë i Oficerit në specialitetin Pilot Ushtarak Helikopteri zgjat 49 javë mësimore-praktike dhe ndahet në dy faza: përgatitja Speciale-Helikopteri dhe Praktika Profesionale. Pjesë e kursit janë 12 kadetë, mes të cilëve edhe një vajzë

Një pjesë e pilotëve të ardhshëm ushtarakë të helikopterëve të Forcës Ajrore shqiptare do të formohen brenda vendit. Në Bazën Ajrore të Farkës u çel Kursi Bazë i Oficerit në specialitetin Pilot Ushtarak Helikopteri, i cili do të ndiqet nga nëntogerë të përzgjedhur nga forca dhe reparte të ndryshme të Forcave të Armatosura.

Në nisjen e këtij kursi, më 2 mars 2021, ishte i pranishëm edhe ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, i cili shoqërohej nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneral-major Bajram Begaj.

Ministri Peleshi e konsideroi nisjen e Kursit të Pilotit si një ngjarje të shënuar, jo vetëm për Forcën Ajrore, por dhe për gjithë Forcat e Armatosura në përgjithësi dhe i siguroi kadetët për mbështetjen e vazhdueshme të Ministrisë së Mbrojtjes.

“Sot ju do të filloni hapin e parë për t’u bërë pjesë e gjeneratës së pilotëve, të cilët jo vetëm e kanë dashuruar profesionin e tyre, por vazhdimisht kanë kryer me sukses dhe profesionalizëm të gjitha detyrat e ngarkuara. Në rrugëtimin që po nisni sot për t’u përgatitur si pilotë të ardhshëm ju do të keni kurdoherë mbështetjen e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm. Unë jam besimplotë se Forca jonë Ajrore do të zhvillohet e modernizohet me ritme të shpejta, do të ketë një vëmendje të veçantë dhe të merituar. Modernizmi teknik i bashkuar, i kombinuar me pasionin dhe përkushtimin e vajzave dhe djemve kështu si jeni ju, janë siguria jonë për të pasur një Forcë Ajrore dinjitoze dhe të aftë për t’iu përgjigjur kërkesave të kohës dhe nevojave të vendit. Do mundësojmë që ato orë fluturimi të domosdoshme për t’u quajtur pilot, ju t’i plotësoni dhe të jeni me të vërtetë gjenerata e re e pilotëve dinjitozë e një Force Ajrore që sa më shumë kalon koha, po modernizohet dhe do të modernizohet.” - u shpreh ministri Peleshi, i cili përshëndeti në mënyrë të veçantë të vetmen vajzë pjesëmarrëse në këtë kurs.

“Do të dëshiroja të përfundoja urimin tim për ju duke e mbyllur në mënyrë të veçantë me Armelën që është një vajzë që do të përgatitet për të qenë pilotja e parë në FA.” Kursi Bazë i Oficerit në specialitetin Pilot Ushtarak Helikopteri zgjat 49 javë mësimore-praktike dhe ndahet në dy faza: përgatitja Speciale-Helikopteri dhe Praktika Profesionale.

Pjesë e kursit janë 12 kadetë, mes të cilëve edhe një vajzë.



MINISTRI I MBROJTJES, NIKO PELESHI

FA do të angazhohen për vaksinimin masiv të popullsisë

Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura kanë qendra që mund të hapen në çdo qytet me mjekë, infermierë, automjetete dhe çdo mjet logjistik për tu vendosur në dispozicion

Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi duke folur nga Korça, e cilësoi ditën e sh-tunë të javës që kaloi, të gëzueshme për personelin mjekësor në vijën e parë të betejës me armikun e padukshëm, ndërsa shtoi se nuk do të ketë nevojë për masa më të forta, nëse do t’i mbajmë numrat nën kontroll.

“Një ditë shumë e gëzuar sot, pasi ka filluar vaksinimi për qarkun e Korçës. Me personelin mjekësor që janë në vijën e parë të betejës me këtë armik të padukshëm. Kam një falënderim të veçantë për të gjithë mjekët dhe infermierët e qarkut që janë në ndihmë të të sëmurëve me Covid-19. Mërzitemi kur dëgjojmë për humbje jete, ndaj sot është zgjidhja përfundimtare. Jemi në një moment jo të mirë të numrave me shifra maksimale, ndaj secili nga ne duhet të jetë i përgjegjshëm për të ruajtur veten dhe të tjerët dhe e gjithë situata se si do të shkojë sëmundshmëria varet nga të gjithë ne. Në rast se ne do t’i mbajmë numrat nën kontroll pa shkaktuar kolapsimin e spitaleve sigurisht që nuk ka nevojë për masa më të forta. Në rast se numrat do



vijojnë të rriten, normalisht që do të ketë shtrëngim të masave. E ardhmja e vaksinimit është optimiste, këtu në Korçë ka nisur për të përfunduar me të gjithë personelin mjekësor dhe më pas do vijohet me moshat mbi 80 vjeç. Kemi sinjale shumë të mira siç e ka thënë edhe KM se Shqipëria do të jetë e para në rajon që do të nisë vaksinimin masiv për të gjithë popullatën dhe besoj se në ditët në vazhdim do të kemi lajme shumë të mira”,

-tha Peleshi.

Nga ana tjetër, Ministria e Mbrojtjes dhe FA janë të angazhuara plotësisht për të asistuar në procesin e vaksinimit. “FA do të jenë në dispozicion të procesit për vaksinimin intensiv”.

Ministri Peleshi tha se: “Mjekët dhe infermierët në uniformë, përfshirë logjistikën e Forcave të Armatosura do të angazhohen për vaksinimin masiv të popullsisë kundër COVID-

19”. “Kemi sinjale shumë të forta, siç e ka përcjellë edhe kryeministri, që Shqipëria do të jetë një nga vendet e para në rajon, shpresoj, që do t’a sigurojë vaksinimin masiv, që do të sigurojë vaksina për të gjithë popullsinë. Kjo na vë në pozitën, kur them ne, të gjitha institucionet që kanë mundësi të japin një dorë në procesin e vaksinimit dhe këtu po flas tani për Forcat e Armatosura, për Ministrinë e Mbrojtjes, na vendos në përgjegjësinë dhe nevojën për të angazhuar të gjitha burimet tona. Forcat e Armatosura do të jenë në funksion të vaksinimit intensiv, masiv. Ne kemi brenda strukturës sonë rreth 100 infermierë, por kemi shumë logjistikë, kemi shumë qendra që mund t’i hapim në çdo bashki, në çdo qytezë, apo fshatra të mëdha në rast se do të gjykohej të ngrihet një sistem i tillë, kemi personel mjekësor, jo vetëm infermierë, edhe mjekë, kemi mjete transporti, kemi shumë logjistikë që do të jetë e gjitha në funksion të vaksinimit intensiv.” - deklaroi ministri Peleshi.

Mesazh urimi me rastin e 8 marsit

“Për ju koleget e mia që shërbeni në Forcat e Armatosura”

Gjeneral Brigade
MANUSHAQE SHEHU
Zëvendës Shefi i Shtabit të
Përgjithshëm të Forcave të Armatosura

8 marsi njihet si “Dita Ndërkombëtare e Gruas”, ditë kur të drejtat e gruas u vunë në agjendën e ditës të politikës mbarëkombëtare. 8 marsi është një ditë e shënuar edhe për gratë shqiptare, të cilat nga dita në ditë e gjejnë veten e tyre më të vlerësuar e më të ndërgjegjshme për rolin e tyre në jetë e shoqëri.

Në këtë kuadër edhe gratë ushtarake dhe civile, ky 8 mars, megjithëse në kushte të veçanta për shkak të COVID-19, i gjen më optimiste për të ardhmen e tyre. Në këtë ditë të shënuar, dëshiroj t’ju drejtohem juve, jo vetëm si Zëvendës shefe e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura e si gjenerale, por si njëra prej jush, si grua, kolege, nënë e motra juaj “Gëzuar festën e Nënës”, Shëndet e lumturi paçi në çdo aspekt të jetës tuaj familjare e shoqërore”!

Në mënyrë të veçantë dëshiroj të përshëndes femrat ushtarake dhe civile, të cilat ky 8 mars i gjen në misionet paqeruajtëse jashtë vendit, në kuadër të NATO-s, OKB-së, BE-së, që nga Sudani i Jugut, Afganistani, Kosova, por edhe në shtabet e NATO-s e Përfaqësitë Ushtarake jashtë vendit. Por ky 8 mars na gjen me fëmërën e parë kandidate për pilote, e cila krahas meshkujve do të përgatitet si pilotja e parë në institucionet arsimore ushtarake shqiptare.

Ashtu sikundër dua të uroj e përshëndes edhe gjithë ato femra ushtarake dhe civile që gjatë këtyre ditëve të fundit, janë përfshirë në përballimin e emergjencave civile si të barabartë e përkrah kolegëve të tyre meshkuj.

Ky 8 mars një pjesë të femrave i gjen në ndjekje online të kurseve të karrierës ushtarake, disa duke kryer po online punën nga shtëpia, disa në krye të detyrave në zyrë, në fushat e poligonet e stërvitjes, në mënyrë të veçantë në përgatitjen për pjesëmarrjen në stërvitjen më të madhe ushtarake të drejtuar nga ushtria e SHBA-së në Europë “Defender 21”, në mbështetjen e furnizimit e reparteve, i gjen pranë anijeve luftarake e pranë mjeteve ajrore, i gjen në patrullim në detyrat policore, në kryerjen e shërbimit të rojes e kudo tjetër ku është nevoja dhe ku e kërkon funksioni organik, duke mos neglizhuar për asnjë çast e moment nga kryerja e detyrave. Por disa gra i gjen edhe të prekura apo të vetëkarantinuara nga sëmundja famëkeqe e COVID-19, ose duke u shërbyer familjarëve të tyre, ashtu siç gjen plot mjeke e infermiere ushtarake duke qenë në vijën e parë të luftës ndaj kësaj sëmundjeje të pamëshirshme, të cilat gjej rastin t’i përshëndes e t’i falënderoj për përkushtimin e humanizmin e

• Ky 8 mars i gjen femrat ushtarake në misionet paqeruajtëse jashtë vendit, në kuadër të NATO-s, OKB-së, BE-së, që nga Sudani i Jugut, Afganistani, Kosova, por edhe në shtabet e NATO-s e Përfaqësitë Ushtarake jashtë vendit.

• Ky 8 mars na gjen me fëmërën e parë kandidate për pilote, e cila krahas meshkujve do të përgatitet si pilotja e parë në institucionet arsimore ushtarake shqiptare.

• “Vlerësim e mirënjohje ndaj grave ushtarake dhe civile për kontributin e dhënë në vite si pjesë e Forcave të Armatosura! Krenare që i keni shërbyer me përkushtim e devotshmëri atdheut, duke sakrifikuar jo në pak raste veten dhe familjen Tuaj! të lumtura”!



treguar ndaj detyrës. Pra ky vit ka qenë i pazakontë, por në të njëjtën kohë vit reflektimi ndaj situatës së krijuar për shkak COVID-19, ruajtja e shëndetit tuaj dhe e të dashurve t’uaj ka shumë rëndësi. Kemi humbur të afërm, miq, por do ti kujtojmë me kujtimet e tyre të bukura me shpresë se kjo situatë nuk do të zgjasë, duke krijuar mundësinë të kthehemi në jetën normale.

Në këtë 8 mars gjej rastin të falënderoj titullarët e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura për kujdesin e mbështetjen e treguar ndaj femrave ushtarake dhe civile, si në rekrutimin, promovimin dhe ecurinë e tyre në detyrë e karrierë. Puna që bëhet për zbatimin e Planit të Veprimit Kombehtar e Planit të Veprimit të Ministrisë së Mbrojtjes për zbatimin e Rezolutës 1325 të Organizatës së Kombeve të Bashkuara “Për Gruan, Paqen e Sig-

urinë”, ka bërë të mundur që gratë ushtarake dhe civile të zenë sot rreth 14.1% të numurit të përgjithshëm të personelit ushtarak aktiv me objektiv e synim për të artitur 15%.

Gjithashtu miratimi para një viti nga Ministri i Mbrojtjes të dokumentit “Politikat dhe procedurat për eliminimin e dhunës, ngacmimit dhe ngacmimit seksual në mjedisin e punës të strukturave të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura”, u ka dhënë femrave më shumë siguri, përkujdesje e mbrojtje nga strukturat shtetërore.

Ku nuk i gjen sot femrat ushtarake dhe ato civile? Ato i gjen, jo vetëm nëntogere, togere, kapitene e majore, por edhe me grada të larta e madhore si nënkolonele, kolonele e deri gjenerale, i gjen komandante strukturash të ndryshme ushtarake, pedagoge, me grada shkencore, drejtore drejtorish, atashe ushtarake etj,



Ashtu sikurse femrat ushtarake në rezervë i gjen sot deputete, biznesmene, por edhe shtëpiake të papuna. 8 marsi është festë për të gjitha, prandaj në këtë ditë të shënuar një urim special dëshiroj t’u jap gjithë atyre ushtarakeve femra, ushtarë profesioniste, nënofficere e oficerë, të cilat për arsye ligjore e kanë ndërprerë karrierën ushtarake ose që për arsye moshe kanë dalë në pension “Gëzuar festën e Nënës, vlerësim e mirënjohje për kontributin e dhënë në vite si pjesë e Forcave të Armatosura! Krenare që i keni shërbyer me përkushtim e devotshmëri atdheut, duke sakrifikuar jo në pak raste veten dhe familjen Tuaj! Qofshi përjetë të lumtura, si nëna e si gjyshe”!

Megjithëse trajtimi dhe vlerësimi që u bëhet sot femrave, ka njohur gjithmonë përmirësim e rritje si në aspektin ligjor, ashtu edhe në zbatimin praktik, përsëri ka vend që si gra të

mos reshtim së kërkuari ndaj strukturave shtetërore, por edhe në familje ndaj bashkëshortëve tanë një trajtim më human e njerëzor.

Prandaj në këtë 8 Mars, që nuk duhet t’a konsiderojmë vetëm si ditë feste, por edhe si ditë të manifestimit të kërkesave tona, ju bëj thirrje grave ushtarake e patjetër edhe atyre civile: Luftoni e kontribuoni më shumë për veten tuaj! Mos pushoni së studiari për të arritur me punë e mundim çdo ambicie profesionale e të karrierës edhe atë që konsiderohet e paarritshme! Luftoni dhe kërkoni të gjejnë zbatim të gjitha ligjet në fuqi që u japin të drejta grave ashtu si edhe burrave! Luftoni e kërkoni që promovimi në detyrë e gradë të mos konsiderohet si “lëmshë e mëshirë” ndaj femrave, por si një e drejtë që ju takon dhe e meritoni! Luftoni dhe kërkoni që edhe në familje të mos jeni pre e dhunës dhe e diskriminimit, siç ndodh në ndonjë rast edhe ndaj femrave ushtarake dhe civile! Kurrë mos pranoni dështimin në karrierën tuaj! Edhe nëse ndodh përpikuni për të bërë të pamundurën. Dështimi juaj duhet të jetë sfidë për të tjerat!

Ambiciet tona si individë, në pozicionin e punës, por edhe në grup si gra duhet të jenë të arrijmë gjithçka që është e mundur, gjithmonë të tregojmë me aftësi e me punë se jemi në gjendje të bëjmë punë të dobishme ndaj shoqërisë dhe atdheut, aq sa edhe burrat.

Por kur këto t’i kemi arritur të dimë t’i vemë në zbatim e të mos zhgënjim në besimin e dhënë ndaj nesh. Mos mendoni asnjëherë se si gra kemi arritur çdo gjë në mbrojtjen e të drejtave tona. Lufta dhe përpjekjet tona duhet të vijojnë edhe në të ardhmen.

Intervistoi: MIMOZA GOLIKJA

Majore Enkelejda Tyrku është pedagogë në AFA, e cila spikat me korrektësinë, përkushtimin dhe angazhimin maksimal në stafin akademik, gjë që e bën figurën e saj si ushtarake, grua dhe nënë, të respektuar dhe vlerësuar që nga koha kur ka veshur mbi supe uniformën e ushtarakes. Majore Enkelejda ka ndjekur studimet në Universitetin e Tiranës në Fakultetin e Histori-Filologjisë, dega Histori dhe më pas ajo ka ndjekur studimet pasuniversitare në Akademinë Ushtarake Skënderbej 2003-2004, si dhe më pas ka përfunduar kursin e Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm në Leavenworth, Kansas. Ka kryer funksione të ndryshme në Brigadë dhe Batalion Artilerie, si specialiste personeli dhe me vonë specialiste stërvitje. Ka punuar në batalionin e dytë të këmbësorisë në Brigadën e Reagimit të Shpejtë dhe më vonë në KDS. Ajo është një nga ushtaraket femra të FA-së që ka marrë pjesë në dy misione të NATO-s në Afganistan. Nga 2014 e në vijim ajo është pedagogë për Historinë Ushtarake në AFA.

Majore Enkelejda Tyrku, mirë se erdhët në faqet e shtypit ushtarak. Ju jeni pedagogë në AFA dhe ne ju kemi zgjedhur pikërisht ju në prag të 7 dhe 8 Marsit për të ndarë eksperiencën tuaj me lexuesin ushtarak dhe jo vetëm. Çdo të thotë për ju, të përçosh dije tek ushtarakët e rinj?

Gjatë shërbimit tim 17 vjeçar në Forcat e Armatosura, mësimdhënia është një nga eksperiencat ku kam mësuar dhe më ka shërbyer për tu rritur profesionalisht. Është një profesion i dyfishtë, je pjesë e botës së bukur të artit të mësimdhënies dhe njëkohësisht pjesë e pandërprerë dhe aktive e misionit fisnik të Forcave të Armatosura. Çdo ditë puna në auditor është një kënaqësi më vete. Në auditoret e Akademisë së Forcave të Armatosura ulen tani edhe studentët eprograzit të studimeve Bachelor në “Studime në Shkencat Ushtarake”, që i jep Akademisë një dimension të ri por edhe i rikthehet traditës shumëvjeçare të arsimit ushtarak. Çdo ditë duke punuar me studentët e të gjitha niveleve, mësoj dhe marr shumë informacion dhe shkëmbim eksperiencash që më ndihmojnë të zgjeroj këndvështrimin tim jo vetëm si mësimdhënëse por edhe si oficerë dhe individ që të arrij një botëkuptim më të gjerë. Stafi i Akademisë është si një familje e madhe, ku çdo pjesëtar vazhdon të japë kontributin për të realizuar misionin e AFA-së dhe për të vazhduar me trashëgiminë e lënë nga puna e ndërtuar nga një gjeneratë e tërë pedagogësh. Në objektivat e mia të rëndësishme, është leximi dhe hulumtimi në mënyrë rigorozë. Çdo ditë në programin tim, studimi zë një pjesë të rëndësishme dhe është burim vital që më jep edhe mundësinë që të hedh themelet solide për vetëzhvillim. Kjo pjesë është shumë e rëndësishme që të angazhohem në mënyrë aktive dhe dinjitozë zhvillimin e programit akademik. Ndiem me fat dhe shumë mirënjohëse, që jam pjesë e stafit të Departamentit të Strategjisë, Studimeve të Avancuara dhe Historisë Ushtarake. Diskutimet dhe bisedat e përditshme akademike me kolegët e Departamentit, e bëjnë ditën time gjithnjë e më interesante. Puna kërkimore, hulumtimet dhe analizat e argumentuara prej secilit prej tyre në lidhje me tematika të ndryshme që trajtohen në programet mësimore është një thesar më vete dhe me vlera të mëdha për mua.

Si po zhvillohet mësimi aktualisht, sa efektive janë kurikulat, pasi jemi në një situatë të pazakontë pandemie të COVID-19, për mësimdhënien online?

Situata e krijuar për shkak të Pandemisë globale të COVID-19, ka ndikuar në të gjitha sferat e jetës dhe sigurisht ka pasur një ndikim të madh edhe në fushën e mësimdhënies. Një sfidë që po e përballojmë të gjithë së bashku. Mësimdhënia në këto kushte ka pjesën e vet të vështirësive dhe barrën e saj të sfidave, si për stafin akademik ashtu edhe për vetë studentët. Megjithatë këto vështirësi që kanë prekur jetët dhe sigurinë shëndetësore të familjeve dhe të dashurve tanë, procesi mësimor vazhdon dhe të gjithë ne po përpiqemi të përshtatemi me kushtet dhe vështirësitë që sjell mësimi në distancë. Bashkëpunimi midis stafit të AFA-së por edhe studentëve na ndihmon që ti përballojmë edhe këto sfida. Për një pedagog prania e studentëve në auditor është më rezultative, por kjo situatë është edhe një lloj testimi, që pavarësisht vështirësive, ne të vazhdojmë dhe të ecim me përmbushjen e misionit akademik.

A është i vështirë profesioni i ushtarakut? Si është për ju të jeni ushtarake, nën uniformë dhe nënë?

Profesioni i ushtarakut është në mënyrë të barazvlefshme i vështirë edhe i bukur njëkohësisht. Është kompleks dhe shumë sfidues, por me përkushtim dhe me punë të vazhdueshme

Rëndësia e profesionit: Ta duash atë dhe të japësh më të mirën nga vetja

Intervistë me majore Enkelejda Tyrku, pedagogë në Akademinë e Forcave të Armatosura



është i mundur. Fillimet janë gjithmonë të vështira. Shpesh në vitet e para të shërbimit si oficerë e re, i drejtoja pyetjen vetes: “A do të mundesh t’ia dalësh me sukses? A do të jem e denjë dhe do ti përmbush të gjitha kërkesat që më ofron detyra ime? Përgjigjet i mora me kalimin e kohës. I lejova vetes time kohë, që vit pas viti të shikoja anët pozitive dhe tëndiqja dritën jeshile “shpresën” që do të më udhëhiqte në të ardhmen dhe në ditët e bukura kur do t’i merrja të gjitha përgjigjet e pyetjeve që më kishin munduar në fillimet e karrierës time. Uniforma bëhet pjesë normale e jetës dhe shpesh kur shikoj njerëz në uniformë, më jep ndjesinë sikur janë njerëz të afërt dhe që i përkasin familjes time të madhe dhe të vogël “të vëllezërve dhe motrave nën armë”. Profesion i ushtarakut me larmishmërinë e specialiteteve që ofron nën uniformë, është një hapësirë e madhe për të përfituar nga gama e gjerë e eksperiencave dhe ekspertizës që sjell çdo ushtarak. Ruajtja e balancës midis profesionit, sfidave e sakrificave që kërkon uniforma me të qenit nënë dhe familjare është pjesa më delikate. Shpesh më është dashur që të luftoj me veten për të dhënë më të mirën dhe për të mos lënë mënjatë të dy këto pjesë të rëndësishme të jetës. Është një luftë e përditshme, që akoma vazhdon të ketë gjithmonë vëmendjen dhe dedikimin tim maksimal për të siguruar më të mirën për të dyja këto role.

Kush ka qenë sfida më e madhe e punës tuaj?

Sfidat janë pjesë normale e jetës. Sfidat kam hasur shumë, por secila prej tyre më ka ndihmuar që të rritem, maturohem dhe të jem edhe më e përgjegjshme si individ dhe si ushtarake. Pas shumë viteve në shërbim aktiv në Forcat e Armatosura dhe përvojave që kam fituar, ndihem se jam bërë pjesë më të drejtë të plota e Forcave të Armatosura. Gjithmonë do të jem falenderuese dhe mirënjohëse të gjithë atyre kolegëve/kolegeve, miqve/mikeshave, eprorëve dhe drejtuesve që më kanë ndihmuar në rrugëtimin tim. Çdo kritikë, çdo sugjerim,

këshillim dhe asistencë më kanë ndihmuar të jem kjo që jam sot. Falenderime pafund për të gjithë. Në eksperiencën personale, sfida më e vështirë mbetet misioni im i parë në Komandën e NATO-s, në kuadër të ISAF, në Kabul në Afganistan. Lashë vajzën time të vogël vetëm 1 vjeçe e gjysmë dhe ky është një ndër momentet më të vështira që nuk do të largohet ndonjëherë nga kujtesa time. Sot që ajo është 10 vjeçe, shpesh më pyet për punën time dhe vështirësitë që has. E shikoj shumë të interesuar dhe kurioze për profesionin tonë dhe uniformën ushtarake. E kam falenderuar vajzën time Antean dhe i shpjegoj që edhe ajo ka dhënë një kontribut të madh dhe ka sakrifikuar shumë, si një heroinë e vogël, për të mbështetur në misionin tonë të përbashkët.

Ju keni 17 vite shërbim në Forcat e Armatosura shqiptare dhe 2 misione ushtarake të rëndësishme duke dhënë kontributin tuaj në strukturat e paqes së NATO-s në Afganistan. Si ka qenë kjo eksperiencë?

Dy shërbimet paqeruajtëse në Afganistan, janë një moment kthese dhe një faqe e re në karrierën time ushtarake. Misioni i parë në periudhën 7 korrik 2012 deri në 22 janar 2013, në Kabul në NTM-A (NATO Training Mission-Afghanistan), ishte koha kur ndryshoi rrënjësisht edhe vizioni im mbi rolin e ushtarakëve. Një shkollë e re më vete dhe një eksperiencë që më rriti profesionalisht si ushtarake. Puna dhe bashkëpunimi me stafet shumëkombëshe më ndihmoi të mësoj dhe të përfitoj një eksperiencë shumë të mirë që do të shërbeje edhe më vonë në karrierën time. Gjatë 6 muajve si pjesë e një stafi profesionist ushtarakësh të pregatitur për operacione kombëtar. Ishte detyrë dhe përgjegjësi shumë e madhe dhe në pozicione të tilla detyra merr vlerë të shumëfishuar. Emri yt atje humbet nën uniformë dhe zmadhohet dhe merr përmasa njerëzore flamuri dhe kombi që përfaqëson. Askush nuk më thërriste në emër, por thjesht “The Albanian Captain”, kapitenia shqiptare. Jua siguroj, se pe-

sha dhe barra e kësaj përgjegjësie rëndonte shumë mbi shpatulla. Në misionin e dytë në shtator 2016-mars 2017, ishte normale të dëgjoja “The Albanian Major”, majorja shqiptare. Në këtë fazë e dija shumë mirë rëndësinë e këtij emërtimi. Në këtë periudhë shërbeva në Komandën e Veriut të NATO-s, në Mazar el Sharif, në kuadrin e RSM (Resolute Support Mission). Misioni i dytë paqeruajtës, më ndihmoi të hedh themele edhe më solide mbi mënyrën e organizimit të punës në zonat operacionale të NATO-s dhe mënyrën e të punuarit në shtabe shumëkombëshe. Në të dyja këto misione, ja kam arritur t’i përmbyll me sukses në saj edhe të bashkëpunimit dhe mbështetjes të kolegëve të mi shqiptarë. Prandaj për mua të gjithë bashkëudhëtarët tanë në uniformë, janë njerëzit e thjeshtë por të sakrificës. Janë njerëzit që punojnë në heshtje, pa dallim gjinie, janë ata që ecin përpara, përballojnë çdo sfidë pa u ankuar, ata janë edhe heronjtë e vegjël që shumë pak i njohin por që kanë një vlerë të madhe dhe të patjetërsueshme.

Gjatë një ceremonie të organizuar më 25 nëntor 2014 në Ministrinë e Mbrojtjes, në prag të 70 vjetorit të çlirimit, për shpërbllimin e personaliteteve me “Medaljen e Mirënjohjes” dhe “Medalje Nderi” për shërbime të jashtëzakonshme gjatë kohës së luftës, juve, që atëherë mbanit gradën kapiten, ministri i Mbrojtjes ju vlerësoi me “Medaljen e Mirënjohjes”. Sa e rëndësishme është kjo për ju?

Ishte një vlerësim i madh dhe u ndjeva e privilegjuar dhe e nderuar. Realisht jam shumë mirënjohëse për të gjitha mundësitë që më janë ofruar. Ndiem shumë e vlerësuar për mirëbesimin që eprorët dhe kolegët e mi kanë pasur tek unë. Të gjitha këto eksperiencat të fituara në vite janë edhe si rezultat i mundësive që më janë ofruar. Përballë këtyre mundësive, gjithmonë vihesha edhe para përgjegjësisë që të punoj më fort dhe të jap më të mirën time për ta realizuar me sukses përmbushjen e misionit tonë si ushtarakë.

Ju jeni një nga tre oficerët e rinj të diplomuar, me diploma masteri, në fushën e studimeve strategjike në SHBA, në korrik 2020, ku përfunduat kursin e Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm në Leavenworth, Kansas. Diçka rreth studimeve atje, sa kohë zgjati ky kurs?

Studimet në SHBA ishin një dritare e madhe drejt botës së pafundme të dijes dhe njëmundësi unike për rritjen profesionale si ushtarake por edhe në sferën akademike. Një udhëtim shumë sfidues, shumë kërkues por edhe një burim i madh përfitimi njohurish. Studimet i nisa në prill të vitit 2019 dhe i përfundova në qershor të vitit 2021. Faza e parë për një periudhë 3 mujore, mora pjesë në kursin për “Përgatitjen e Edukimit Ushtarak Profesional në “Institutin e Mbrojtjes së Gjuhës në Qendrën e Gjuhës Angleze” DLI në Bazën Forcave Ajrorenë Lackland, Texas. Në fazën e dytë zhvillova “Kursin e Komandës dhe

Oficerit të Shtabit të Përgjithshëm” në Kolegjin e Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm në Fort Leavenworth, Kansas. Gjithashtu pata fatin dhe mundësinë të ndiqja studimet në “Masterin e Shkencave dhe Artit Ushtarak, në fushën e studimeve strategjike.

Sa ndikoi ky arsimim, në një nga akademitë ushtarake më elitare të SHBA-së, tek ju si oficerë re por dhe për FA-në? Sa domethënëse është për karrierën e një ushtaraku të studiojë në SHBA?

Kjo periudhë edukimi në SHBA mëndihmoi që të kuptoj dhe të jem në gjendje të aplikoj më mirë doktrinat ushtarake dhe të rris aftësinë e të punuarit në grup dhe në stafe shumëkombëshe. Mësova shumë mbi operacionet ushtarake, taktikat, strategjinë, leadershipin, historinë ushtarake dhe subjekte të tjera që janë të nevojshme për të kompletuar njohuritë që duhet të ketë një oficer karriere që të jetë edhe i aftë të punojë në detyra të ndryshme në kuadër të NATO-s por edhe të angazhimeve të tjera të FARSH. Akademia ushtarake në SHBA më ndihmoi që të thelloj aftësitë e mia analitike për zgjidhjen e problematikave të ndryshme në fushën e mbrojtjes dhe tësigurisë. Mësimet e marra në fushën e mendimit kritik dhe leadershipit ishin shumë me vlerë për të kuptuar rëndësinë e komandimit efektiv dhe rolin e veçantë që kishte efektiviteti i punës në grup. Studimet master për fushën e strategjisë më dhanë mundësinë që të punoj me një staf akademik profesional që më ndihmoi të hidhja baza solide mbi punën kërkimore dhe aplikimin e koncepteve strategjike. Një eksperiencë që më shërben edhe në detyrën time aktuale në fushën e mësimdhënies në AFA. Të gjitha këto njohuri janë një vlerë e shtuar sepse ndihmojnë çdo ushtarak në shërbim të FARSH që t’i vendosë në praktikë, në detyrat e të ardhmes ku do të duhet të shërbejë në kuadër të NATO-s apo edhe OKB-së sipas kërkesave dhe nevojave të FARSH-it.

Majore Enkelejda, mendon se është e vështirë të punosh në një ambient ku mbi-zotërojnë burrat, ndjehet e paragjykuar një femër, si është kjo në aspektin gjinor?

Shpesh në këndvështrimin e përgjithshëm, profesione të caktuara shikohen si domeine të njërës apo tjetrës gjini. Të jesh pjesë e Forcave të Armatosura sigurisht nuk është e thjeshtë, kërkon shumë punë, përkushtim dhe disiplinë të hekur, por nuk është e paarrtishme. Vitet e gjata në shërbim të bëjnë të kuptosh rëndësinë e profesionit por edhe të kolektivit dhe bashkëpunorëve tanë. Respekti fitohet me shumë punë, përkushtim dhe vite të gjata përvojë. Gjatë shumë viteve ku na duhet të përballojmë sfida të përbashkëta në shërbime dhe misione të vështira që të gjithë ne ushtarakët aktivë nën uniformë, bëhemi pjesë e familjes së madhe të Forcave të Armatosura. Të gjithë bashkë kemi një mision të përbashkët dhe i shërbejmë kombit tonë, dhe objektivi madhor është që ta realizojmë misionin tonë me sukses dhe në standarte profesionale. Duke e bërë këtë analizë, në përfundim më duket se ka shumë pak vend për ide ku duhet të ekzistojë paragjykim i për shkak të gjinisë.

Çfarë do t’ju thonit oficerëve/ushtarakëve të rinj, si në aspektin profesional duke qenë pedagogia e tyre, por edhe atë personal, çfarë do të këshillonit ju për ta?

Duajeni profesionin tuaj, bëjeni atë pjesë të jetës tuaj dhe jepni më të mirën nga vetja. Mos reshtni asnjëherë së punuari, së eksploruari çdo mundësi dhe eksperiencë të re që do t’ju ofrohet nga shërbimi në FARSH. Qëndroni mendjehapur për të mësuar dhe mos reshtni kurrë së kërkuari dije, sepse është e sigurt që do t’ju udhëheqë në një rrugëtim fantastik që do t’ju surprizojë se sa shumë mund t’ju ndryshojë dhe zgjerojë botëkutin tuaj. Sfidat dhe vështirësitë janë pjesë e profesionit të ushtarakut, por jo më kot ata janë edhe njerëzit më të veçantë që transmetojnë vlera unike, për sakrificat dhe kontributin që japin në çdo cep të globit ku detyra i thërret. Ushtarakët ambasadorët e paqes dhe stabilitetit janë ata që e mbajnë flamurin shqiptar dhe transmetojnë vlerat më fisnike shqiptare kudo që shkojnë. Mos reshtni së treguari vlerat e profesionit dhe të kombit që përfaqësoni.

Modernizimi i Forcave të Armatosura

Ushtria Amerikane dhuron 29 mjete "Humvee" për Forcat e Armatosura

Ushtria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës do të ndihmojë në rritjen e gatishmërisë ushtarake shqiptare dhe ndërveprimit të saj me NATO-n

Ushtria e SHBA-së i ka dhuruar Forcave të Armatosura të Shqipërisë 29 automjete, të njohura si "Humvee". Lajmin e ka bërë me dije Ambasada e SHBA-ve në vendin tonë javën që kaloi, ditën e enjte, më 25 shkurt 2021, duke shtuar se këto mjete dhe do të ndihmojnë në rritjen e gatishmërisë ushtarake shqiptare dhe ndërveprimit të saj me NATO-n.

"Njëzet e nëntë Automjete shumë-përdorimshe me lëvizshmëri të lartë (Humvee) mbërritën javën që kaloi, ditën e enjte, më 25 shkurt 2021 në Portin e Durrësit. Këto automjete janë dhurim për Forcat e Armatosura të Shqipërisë nga Ushtria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe do të ndihmojnë në rritjen e gatishmërisë ushtarake shqiptare dhe ndërveprimit të saj me NATO-n", -thuhet në njoftimin e Ambasadës Amerikane në Tiranë.

Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi në reagimin e tij shprehet se modernizimi i FA-së vijon dhe falë bujarisë së SHBA-së. "Modernizimi i Forcave tona të Armatosura vijon edhe falë bujarisë së popullit të SHBA-së. 29 automjete të blinduara, të lëvizshmërisë së lartë, mbërritën sot në portin e Durrësit, për të hyrë menjëherë në përdorim të Forcës Tokësore", -shprehet Peleshi në facebook.

Automjeti shumë-funksional, me lëvizshmëri të lartë (Humvee) është një mjet ushtarak me 4-rrota i prodhuar nga AM General. Në qershor 1981, ushtria amerikane lidhi një kontratë me AM Gjeneral dhe 55 mijëcopë automjete Humvee u prodhuan në vitin 1985. Humvee për herë të parë u përdor në operacionin "Just Cause", në pushtimin e Panamës në 1989.

Ai ka zëvendësuar mjetin M151 dhe M561 "Gama Goat". Kryesisht pëdoret nga ushtria e SHBA-së, por gjithashtu ato përdoren edhe nga



shumë vende të tjera, po kështu edhe nga Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Përdorimi i Humvee-s në Luftën e Gjirit Persik ndihmoi në promovimin e markës civile Hummer. Të paktën 17 variante të Humveejanë

nëshërbim me Forcat e Armatosura të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Humveekonsiderohet si kali i punës për forcat e SHBA-ve në të gjithë botën. Më shumë se 10,000 të tillë u përdoren nga forca e koalicionit në Luftën Irakut.

Kursi zhvillohet në Zall-Herr nga data 6 prill deri më 6 tetor 2021



Fillojnë aplikimet për Kursin Bazë të Forcave Speciale

Regjistrimi ka filluar më datë 15 shkurt dhe do të vazhdojë deri më datë 7 mars 2021

Batalioni i Forcave Speciale (bFS) hap Kursin e XIII-të Bazë të Forcave Speciale. Kandidatët që do të aplikojnë për të marrë pjesë në Kursin e XIII-të Bazë të Forcave Speciale, të paraqiten pranë personelit të reparteve përkatëse për të dorëzuar dhe plotësuar dokumentacionin e nevojshëm, ose t'a plotësojnë atë tek personeli i bFS në Zall-Herr, Tiranë. Regjistrimi ka filluar më datë 15 shkurt dhe do të vazhdojë deri më datë 7 mars 2021. Datat për zhvillimin e testimit përzgjedhës janë nga data 07-18 mars 2021, kurse shpallja e kandidatëve fitues bëhet në datën 25 mars 2021. Kursi zhvillohet në Zall-Herr dhe fillon më datë 6 prill 2021 deri në datën 6 tetor 2021.

Kriteret për regjistrimin e kandidatëve:

Të jetë ushtarak aktiv në FA (Oficer, Nënoficer dhe Ushtar Profesionalist). Të mos jetë i dënuar apo i ndjekur penalisht nga organet e drejtësisë. Të ketë një trup me fizik të rregullt, të shëndetshëm, pa tatuazh, pa mangësi apo shenja që deformojnë pamjen. Të mos jetë bartës i virusit HIV dhe Hepatitit B dhe C, të mos ketë kaluar sëmundje të zemrës, veshkave, mëlçisë dhe mushkërive. Të ketë gjatësi trupore mbi 170 cm. Mosha maksimale 30 vjeç. Kandidati që nuk plotëson një nga kriteret e përmendura më sipër, skualifikohet.

Për oficerët, të jetë me gradën Nëntoger deri në Kapiten. Për nënoficerët, të jetë me gradën Nëntetar deri në Tetar. Për ushtarët profesionist. Ushtar I deri Ushtar IV, të ketë kryer stërvitjen individuale bazë dhe të avancuar të ushtarit.

Dokumentat e nevojshme:

Kërkesë me shkrim e nënshkruar nga kandidati ku të jepet arsyeja e ndjekjes së kursit. Fotokopje e ID. Të dhënat e pesonelit sipas formatit ushtarak të firmosur nga shefi i personelit të njësisë ku shërben.

Pikë kontakti:

Komandanti i kursit: tel +355682522293 email: albankurti@aaf.mil.al Personeli: tel zyre 532 1001 email: ardjanballa@aaf.mil.al Adresa: Zall-Herr, Tiranë

Me heronjtë e helikopterit AS 532 AL

Forcat Ajrore në luftë për të shpëtuar jetët njerëzore

Helikopterët e Forcave Ajrore drejtohen nga një personel i përgatitur profesionalisht, i përkushtuar për zbatimin e detyrave. Ata janë njerëz të zakonshëm që në ditë të jashtëzakonshme janë pranë komunitetit, në çdo rast e në çdo kohë, por kjo më e theksuar sidomos në përmbajtjet e krijuara në zona të ndryshme të vendit, ku rrezikohet jeta e banorëve, jo vetëm këtë vit por edhe vite më parë.

Një prej tyre është reshter Bledi Zaimi, aereoshpëtues në grupin e helikopterëve AS 532 AL dhe tetar Ermir Locaj, vinçier në grupin e helikopterëve AS 532 AL të cilët tregojnë vështirësitë por edhe gëzimin kur shpëtojnë jetë njerëzore.

Këta njerëz me uniformë ushtarake shkëputen nga toka për të kapur qiellin, për të qënë heronj në ditë të vështira. Reshter Bledi Zaimi, aereoshpëtues në grupin e helikopterëve AS 532 AL kujton një prej rasteve të vështira dhe tregon dinamikën e operacionit që nga mar-



rja e informacionit e deri në mbylljen me sukses të operacionit: "Na vjen njoftimi që në zonën e Marllkuçit rrezikohet jeta e një familjeje dhe në jetën time nuk isha përballur me një përmbajtje aq të madhe. Në mënyrë urgjente morëm të gjitha masat, u ngritëm në ajër me helikopter dhe duke ndjekur koordinatat arritëm tek familja e parë ku ndodheshin 8 persona në zonën e rrethuar me ujë nga të katër anët. Vendosëm se kush ishte më prioritar dhe këta ishin gratë dhe fëmijët." Tetar Ermir Locaj, vinçier në grupin e helikopterëve AS 532 AL, thotë se kishte shumë

vështërsi për tu ulur. "Kishte shumë vështërsi, telat elektrike në njërën anë, në anën tjetër pemët, tejdukshmëria e ulët, etj. Dolën banorët dhe po kërkonin ndihmë. Ka zbritur Bledi dhe arritëm të komunikojmë me familjarët të cilët ishin shumë të rënduar psikologjikisht dhe fizikisht, morëm një fëmijë të vogël me nënën e vet, pastaj familjarët e tjerë. Shpëtimi i jetës së njerëzve është primare", -u shpreh tetar Ermir Locaj. Tëshpëtosh jetë dhe të shikosh që shpresa rilind sërish nuk është thjeshtë një punë por njëmision i rëndësishëm për të cilin ata ndihen krenarë.

Shpallje vend i lirë pune

Specialist për dokumentacionin, në Policinë Ushtarake

Aplikimi nga të interesuarit ka filluar më 24 shkurt 2021 dhe mbyllet më 10 mars 2021

Policia Ushtarake, Reparti Ushtarak nr. 6620, Rinaska shpallur vend të lirë pune përpozicionin: specialist administrim dokumentacioni/arkivist, me pagë mujore 35,400 lekë. Aplikimi nga të interesuarit ka filluar më 24 shkurt dhe data e mbylljes së aplikimeve është data 10 mars 2021.

Dokumentet e aplikimit:

Aplikantët duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme: kërkesën; formularin e aplikimit; fotokopje të kartës së identitetit; diplomën e shkollës së mesme/parauniversitare ose të lartë të noterizuar ose në origjinal; fotokopje të patentës nëse ka; dëshmi profesioni nëse ka; certifikatë ose dëshmi të gjuhëve të huaja raport mjekësor; fotografi me përmasa 4x6, 2 copë; dëshmi penaliteti; vërtetim nga gjykata; vërtetim nga prokuroria; librezë pune; jetëshkrimin (CV), formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në faqen e internetit të MM-së në adresën elektronike www.mod.gov.al. (linku: Baza ligjore/Akte ligjore/Integriteti i personave që ushtrojnë funksione publike/formulari i vetëdeklarimit).

Kërkesat e përgjithshme të pozicionit të punës: Të ketë shtetësinë shqiptare; të jetë jo më pak se 18 vjeç; të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar; të plotësojë kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor, si dhe të zotërojnë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin përkatës të punës, sipas kritereve të miratuara; të jetë i aftë për punë nga ana shëndetësore; të mos jetë të dënuar me burg me vendim gjykate të formës së prerë për kryerje të një krimi; të mos jetë marrë masa disiplinore me largim nga puna, brenda 1 viti nga data e aplikimit.

Kërkesat specifike të pozicionit të punës:

Grada/Titulli: N/C. Arsimi: i mesëm. Kualifikimi: B8 d. Trajnimi: Kurse/trajnime të ndryshme e. Eksperienca në Punë: 3 vite. Gjuha e huaj: 1/1/1/1 g. Kërkesa të tjera specifike: e pa aplikueshme. Niveli i certifikatës së sigurisë: Sekret.

Përshkrimi i punës:

Funksioni i vendit të punës “Specialist administrim dokumentacioni/arkivist”, Funksioni i vendit të punës N/C në Sektorin e Policisë Kriminale në Seksionin e Analizës në Policinë Ushtarake, bën administrimin e dokumentacionit të ardhur dhe prodhuar. Nën drejtimin e Shefit të Seksionit të Analizës, punon për kryerjen e detyrës funksionale, administrimin e dokumentacionit të prodhuar dhe ardhur në Seksionin e Analizës. Administron dokumentacionin dhe literaturën “Sekrete” për punën e Sektorit të Policisë Kriminale. Administron dokumentacionin në ngarkim të personave kontigjent të Policisë Kriminale. Bashkëpunon me Seksionin e Sekretarisë së Policisë Ushtarake në interes të përmbushjes dhe mbarëvajtjes detyrës funksionale.



Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një komision vlerësimi i përbërë nga 3 (tre) vetë. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve përfshin: përzgjedhjen paraprake; vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën përkatëse; intervistën e strukturuar me gojë. Përzgjedhja paraprake e kandidaturave do të realizohet nga Njësia e personelit të strukturës që është e interesuar për rekrutimin, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët. Njësia e personelit verifikon dokumentacionin e aplikantëve, nëse ai është i plotë dhe i saktë, si dhe plotësimin e kërkesave të pozicionit të punës nga ana e tyre dhe përcakton kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit. Vetëm kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit do të njoftohen për vazhdimin e mëtejshëm të konkurimit. Konkurimi me kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit të punës përfshin: vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve (vlerësimin e arsimimit/kualifikimit, vlerësimin e trajnimit dhe vlerësimin e eksperiencës të lidhura me fushën përkatëse; interv-

istën e strukturuar me gojë. Vlerësimi i tyre do të bëhet nga komisioni përkatës. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 (njëqind), të cilat ndahen: 40 pikë, për vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve; 60 pikë,

e eksperiencave të ngjashme të punës; Pikët totale të vlerësimit të dokumenteve ndahen, si më poshtë: jetëshkrimi, 5 pikë; arsimimi/kualifikimi, 15 pikë; trajnimi, 5 pikë; eksperiencia/përvoja në punë, 15 pikë.



për intervistën e strukturuar me gojë. Vlerësimi i dokumenteve të kandidatëve përfshin: vlerësimin e jetëshkrimit (CV); vlerësimin e kualifikimeve akademike, profesionale dhe teknike; vlerësimin e trajnimeve; vlerësimin

Intervista zhvillohet me gojë me të gjithë kandidatët që janë përzgjedhur gjatë fazës së përzgjedhjes paraprake. Qëllimi i intervistës është të verifikojë aftësitë, motivacionin dhe aspiratat e çdo kandidati, si dhe përputhshmërinë

e profilit profesional të kandidatit me pozicionin që do të mbulojë.

Intervista zhvillohet e strukturuar me qëllim që të sigurojë informacion të saktë rreth profilit profesional të kandidatëve. Ajo strukturohet në varësi të pozicionit që punonjësi do të mbulojë dhe eksperiencës. Gjatë intervistës kandidatit i drejtohen disa pyetje nga anëtarët e komisionit, përgjigjet e të cilave vlerësohen me pikë. Çdo pyetje ka një sasi të caktuar pikësh, të cilat vlerësohen në varësi të përgjigjes. Në total intervista ka 60 pikë. Në mbyllje të procesit të vlerësimit, tre kandidatët që kanë marrë më shumë pikë i paraqiten autoriteteve vendimarrëse për miratimin e kandidatit më të përshtatshëm për mbulimin e pozicionit të shpallur. Me emërimin në pozicionin e punës do të lidhet kontrata individuale e punës.

Shënim: Aplikuesi duhet të deklarojë se të dhënat e mësipërme janë të vërteta. Nëse merret në punë dhe vërtetohet e kundërta, ai pranon prishjen e kontratës së punës pa paralajmërim dhe dëmshpërblim. Ai duhet të deklarojë se është në dijeni për të



kërkuar me shkrim konfirmimin që të dhënat do të përdoren vetëm për qëllime seleksionimi për punësim pranë FA-së. Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të njoftohen për intervistën. Në rastin e përzgjedhjes së kandidatit, aplikimi dhe të gjithë dokumentat shoqëruese mbeten në pronësinë e FA-së. dhe nuk mund të kthehen. Në rast se kandidati nuk përzgjidhet për vendin e lirë për të cilin aplikon, Forcat e Armatosura nuk do të ruajnë të dhënat nga aplikimi apo dokumente të tjerë shoqërues dhe ky aplikim nuk do të konsiderohet për vende e lira që do shpallen në të ardhmen. Në këtë rast, çdo aplikant që nuk është përzgjedhur, ka të drejtë të tërheqë të dhënat e tij personale brenda një periudhe kohore prej 1 muaji nga afati i shpallur për përzgjedhjen e kandidatit për punë.

Një krizë shëndetësore të mos kthehet në një krizë sigurie

Stoltenberg në KE: NATO dhe BE duhet të bëjnë më shumë së bashku

90 për qind e qytetarëve të BE-së jetojnë në një vend të NATO-s dhe ne ndajmë të njëjtin rajon dhe të njëjtat sfida

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg iu drejtua takimit të udhëheqësve në Këshillin Evropian më 26 shkurt 2021, duke argumentuar për forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit NATO-BE dhe iniciativën NATO 2030.

Duke folur së bashku me Presidentin Charles Michel para takimit, Sekretari i Përgjithshëm tha se sfidat e sotme janë shumë serioze për çdo vend apo kontinent për t'u përballur vetëm, por kërkojnë që Evropa dhe Amerika e Veriut të punojnë së bashku edhe më ngushtë.

Ai shtoi se 90 për qind e qytetarëve të BE-së jetojnë në një vend të NATO-s dhe ne ndajmë të njëjtin rajon dhe të njëjtat sfida, kështu që NATO dhe BE duhet të ndërtojnë një bashkëpunim tashmë të fortë për të rritur qëndrueshmërinë e shoqërive tona, të investojnë në teknologji të reja, ndryshimi i klimës dhe mbështetja e partnerëve.

Deklarata e përbashkët nga Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg dhe Presidenti i Këshillit Evropian, Charles Michel përpara takimit të Këshillit Evropian

“Falënderoj ju dhe Bashkimin Evropian për atë që bëni, duke u siguruar që ne jemi në gjendje të luftojmë koronavirusin, pandeminë COVID-19, sepse përpjekjet e Bashkimit Evropian, të Shteteve Anëtare të Evropës, kanë kanë qenë jashtëzakonisht të rëndësishme për të gjithë ne që jetojmë në Evropë.

Në të njëjtën kohë, ne shohim se forcat tona ushtarake në të gjithë Evropën po mbështesin përpjekjet civile, duke ndihmuar në ngritjen e spitaleve ushtarake në terren, transportimin e pacientëve, pajisjet mjekësore. Pra, në një mënyrë, ne në fakt shohim se si sektori civil, përpjekjet e BE po shkojnë krah për krah me përpjekjet ushtarake në të gjithë kontinentin.

Për NATO-n, detyra kryesore gjatë kësaj pandemie ka qenë të sigurojë që një krizë shëndetësore të mos kthehet në një krizë sigurie, sepse kërcënimet me të cilat jemi përballur para pandemisë, ato janë akoma atje.

Veprimet agresive të Rusisë, format më brutale të terrorizmit, sulmet e sofistikuar kibernetike, ngritja e Kinës dhe implikimet e sigurisë së ndryshimit të klimës, kështu që asnjë vend ose kontinent nuk mund të përballet vetëm me këto sfida. Jo vetëm Evropa, jo vetëm Amerika e Veriut, por Evropa dhe Amerika e Veriut së bashku dhe prandaj si ju, unë mirëpres mesazhin shumë të fortë nga administrata e re e Biden, për të rindërtuar aleanca, për të forcuar lidhjen transatlantike. Dhe kjo do të jetë gjithashtu çështja kryesore kur udhëheqësit e NATO-s takohen më vonë këtë vit në Bruksel.

NATO 2030 është një projekt ku ne po shohim se si mund ta forcojmë më tej NATO-n, lidhjen transatlantike, dhe që përfshin gjithashtu mënyrën se si ne mund të forcojmë bashkëpunimin me Bashkimin Evropian.

Gjatë viteve të fundit ne kemi qenë në gjendje të ngremë bashkëpunimin midis Bashkimit Evropian dhe NATO-s në nivele të papara. Unë e vlerësoj shumë lidhshërinë tuaj për këtë, angazhimin tuaj për bashkëpunimin NATO-BE



dhe pres që të vazhdoj të punoj me ju dhe Bashkimin Evropian për çështje të tilla si rezistenca, si kiberneti, si kundërveprimi me efektet e ndryshimit të klimës për të punuar në çështje ku ne kemi punuar së bashku për shumë vite si stabilizimi i Ballkanit Perëndimor dhe trajtimi i migrimit në Egje.

Më shumë se 90% e njerëzve që jetojnë në Bashkimin Evropian, ata jetojnë në një vend të NATO-s. Kështu që thjesht ilustron se ne ndajmë, pothuajse të njëjtën popullsi, të njëjtët anëtarë, dhe të njëjtin rajon dhe të njëjtat sfida. Kështu që e gjithë kjo e bën të përkryer, absolutisht, të qartë se ne duhet të punojmë së bashku, dhe kjo është arsyeja pse unë pres që të takohem me Këshillin Evropian dhe të trajtoj se si ne mund të forcojmë më tej bashkëpunimin NATO – BE.”

NJË QASJE NË NDRYSHIM E SIGURISË

NATO rrit punën në Qasjen e Sigurisë Njerëzore

Më 25 shkurt 2021, në një konferencë të nivelit të lartë në internet, NATO diskutoi se si të përmirësojë qasjen e saj të sigurisë njerëzore si pjesë e një përpjekjeje më të gjerë kolektive me një komunitet ndërkombëtar me interes duke përfshirë ekspertë kombëtarë, shoqëri civile, think tank dhe përfaqësues akademikë.

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg hapi ngjarjen. Siguria njerëzore është “në zemër të asaj që jemi dhe asaj që bëjmë: një Aleancë që punon së bashku për të mbrojtur njerëzit tanë dhe vlerat tona - lirinë, barazinë, të drejtat e njeriut”, tha ai. “Marrja e një qasjeje të sigurisë njerëzore është mënyra më e mirë për të arritur paqe dhe siguri të qëndrueshme”.

Dialogu dixhital për Sigurinë Njerëzore në NATO u moderua nga Dr. Jamie Shea dhe mbledhi më shumë se 500 pjesëmarrës. Clare Hutchinson, Përfaqësuesja Speciale e Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, Shefi i Ajrit Marshalli Sir Stuart Peach, Kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s, Profesor Mary Kaldor nga Shkolla e Ekonomisë dhe Shkencave Politike të Londrës, Dr. Walter Dorn nga Ushtria Mbretërore, Kolegji i Kanadasë dhe Kolegji i Forcave Kanadeze, Eva Svoboda, Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, gjithashtu morën pjesë në veprimtarinë.

Pesë linjat kryesore të përpjekjeve të NATO-s nën Sigurinë Njerëzore janë: mbrojtja e civilëve; fëmijët dhe konfliktet e armatosura; lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore; parandalimi dhe reagimi ndaj dhunës seksuale të lidhur me konfliktet; dhe mbrojtja e pasurisë kulturore.

Në Samitin e Londrës në NATO në 2019, aleatët kishin rënë dakord të rrisnin rolin e NATO-s në sigurinë njerëzore. Në muajt e ardhshëm, arrijtje të reja priten me zhvillimin e një politike të NATO-s për parandalimin dhe reagimin ndaj dhunës seksuale të lidhur me konfliktin dhe azhurnimin e politikës së NATO-s për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Iniciativa e NATO-s 2030 do të ndihmojë për të

cuar përpara këtë agjendë. Puna e vazhdueshme në axhendën e Grave, Paqes dhe Sigurisë të NATO-s gjithashtu luan një rol të rëndësishëm në adresimin e perspektivës gjinore të sigurisë.

Më poshtë po sjellim fjalën e Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg në konferencën për Sigurinë Njerëzore të organizuar nga NATO

“Siguria njerëzore ka rëndësi për NATO-n. Është në zemër të asaj që jemi dhe asaj që bëjmë: Një Aleancë që punon së bashku për të mbrojtur njerëzit dhe vlerat tona - lirinë, barazinë, të drejtat e njeriut.

Në 2019, Udhëheqësit e NATO-s vendosën të rritnin punën tonë për sigurinë njerëzore. Për të adresuar edhe më aktivisht ndikimin që ka një konflikt ose krizë tek gratë, burrat dhe fëmijët. Sa i përket mënyrës se si ne planifikojmë dhe veprojmë për të ndihmuar në përmirësimin e sigurisë së tyre. Kjo është arsyeja pse ne jemi duke punuar në mënyrë aktive për të zvogëluar dëmin e mundshëm ndaj civilëve në zonat e konfliktit. Në Afganistan dhe Irak, ne trajnojmë forcat tona dhe forcat lokale për të rritur ndërgjegjësimin e tyre për mbrojtjen e civilëve dhe në Kosovë, ne ndihmojmë në mbrojtjen e pronës kulturore.

Marrja e një qasjeje të sigurisë njerëzore është mënyra për të arritur paqen dhe sigurinë e qëndrueshme. Ne e dimë se kur komunitetet kanë vuajtur nga trafikimi i qenieve njerëzore, nga dhuna seksuale e lidhur me konfliktin, ose nga shkatërrimi i pasurisë kulturore, fundi i konfliktit është më i vështirë për tu arritur dhe pagja është më e brishtë.

Këto krime lënë shenja për breza të tërë. Ato pengojnë rrugën drejt një të ardhme të qëndrueshme. Për t'i trajtuar ato më mirë, NATO ka politika dhe udhëzime të vendosura dhe ne i trajnojmë ushtarët

tanë të njohin dhe raportojnë krime të tilla. Ne gjithashtu vendosim standarde të sjelljes që përdorim në operacione dhe trajnime. Këto standarde na mbrojnë ne dhe ata, nga ata që përdorin apo kryejnë dhunë. Ato i mbajnë civilët më të sigurt dhe ato mishërojnë vlerat tona.

Ne do të azhurnojmë vazhdimisht standardet tona në mënyrë që të njohim më mirë gamën e plotë të kërcënimeve dhe rreziqeve për popullatat, për t'u përgatitur më mirë për t'u përgjigjur dhe të fitojmë besimin e komuniteteve që u shërbejmë. Ndërsa rritim më tej punën tonë, ne do të vazhdojmë të angazhohemi me partnerët tanë, me organizatat ndërkombëtare dhe shoqërinë civile.

Në fillim të këtij muaji, (shkurt) ne gjithashtu u angazhuam me studentë nga e gjithë Aleanca. Ata garuan në hakatonin e parë të politikës së NATO-s dhe ndanë ide të shkëlqyera, përfshirë sigurinë njerëzore dhe mënyrën e mbrojtjes së civilëve në konfliktet e ditëve moderne. Sepse ndërsa natyra e konfliktit ndryshon, ashtu duhet të kemi qasjen tonë ndaj sigurisë. Ata na thanë, për shembull, pse duhet të marrim parasysh sigurinë njerëzore ndërsa zhvillojmë aftësitë tona të reja ushtarake, dhe çfarë ndikimi mund të ketë konflikti në mega-qytete tek njerëzit. Kontributet dhe perspektivat e tyre janë thelbësore. Kështu janë edhe tuajat. Ato pasurojnë bisedën dhe mendimin tonë për sigurinë njerëzore që shkon përpara.

Ky dialog dixhital është një mundësi për të ndihmuar në avancimin e punës së NATO-s për këtë çështje thelbësore. Kështu që të jemi më të përgatitur për sfidat e sotme dhe të nesërme dhe mund të vazhdojmë t'i mbajmë njerëzit tanë të sigurt.”

Këshilli i Atlantikut të Veriut

NATO, platformë për mbrojtjen dhe respektimin e vlerave demokratike

Sekretari i Përgjithshëm mirëpret Asamblenë Parlamentare të NATO-s në një moment të rëndësishëm për komunitetin transatlantik

Anëtarët e Asamblesë Parlamentare të NATO-s (NPA) morën pjesë në një takim virtual me Këshillin e Atlantikut të Veriut, në 2 mars 2021, për të shkëmbyer mendime mbi axhendën e NATO-s për vitin. Takimi u përqëndrua në përgatitjet për Samitin e NATO-s 2021, në veçanti në përshtatjen e Aleancës përmes iniciativës NATO 2030. Sekretari i Përgjithshëm falënderoi parlamentarët për kontributet e tyre aktive dhe të vlefshme në procesin e NATO-s 2030. Këshilli i Atlantikut të Veriut dhe NPA diskutuan rëndësinë e vendosjes së vlerave demokratike në qendër të adaptimit të ardhshëm të NATO-s. “NATO është një platformë për mbrojtjen e vlerave demokratike dhe Aleanca duhet të respektojë vlerat e saj themelore” tha Sekretari i Përgjithshëm. Ishte gjithashtu një mundësi për të diskutuar azhurnimin e konceptit strategjik, ndarjen e barrës, rezistencën dhe pandeminë COVID-19.

Ky takim vjetor i përbashkët është pjesë e konsultave të rregullta midis Këshillit të Atlantikut të Veriut dhe NPA. NPA është një organizatë ndërparlamentare, që bashkon parlamentarë nga Aleatët e NATO-s dhe vendet e asociuara për të shqyrtuar çështjet kryesore të sigurisë dhe politikave me të cilat përballet Aleanca, për të shqyrtuar çështje të lidhura me sigurinë me interes dhe shqetësim të përbashkët. Që nga vitet 1980, ajo ka marrë role shtesë duke integruar në punën e saj parlamentarë nga vendet partnere të NATO-s në Evropë dhe më gjerë.

PA e NATO-s u krijua në 1955 për të angazhuar parlamentarë në çështje transatlantike dhe për të ndihmuar në



ndërtimin e konsensusit parlamentar dhe publik në mbështetje të politikave të Aleancës. Që nga vitet 1980, ajo ka zgjeruar shtrirjen e saj për të zhvilluar marrëdhënie të ngushta me udhëheqësit politikë nga Evropa Qendrore dhe Lindore, si dhe nga Lindja e Mesme dhe

Afrikën e Veriut. Asambleja përqendrohet në çështjet kryesore të sigurisë dhe politikave me të cilat përballet Aleanca, duke prodhuar raporte që miratohen me shumicë votash. Pesë komitete dhe tetë nën-komitete kryejnë punën e tij dhe mban afërsisht 40 aktivitete në vit.

PËRGJIGJA NDAJ KORONAVIRUSIT



Mbështetja e NATO-s për Republikën e Moldavisë

Më 24 shkurt, Republika e Moldavisë mori 25,000 kostume të disponueshme për mbrojtje biologjike (Tyvek 600+) nga Fondi i Mirëbesimit të Përgjigjes Pandemike të NATO-s. Dhurimi u koordinua nga Qendra Koordinuese Euro-Atlantike e Reagimit të Fatkeqësive të NATO-s (EADRCC) në përgjigje të kërkesës së Moldavisë për ndihmë ndërkombëtare. Kjo u bë e mundur me kontribute financiare nga Luksemburgu dhe Norvegjia. Pajisjet Mbrojtëse Personale do të përfitojnë nga stafi mjekësor në Spitalin Klinik Komunal për Fëmijë “Valentin Ignatenco”, në Kishinau, si dhe institucione të tjera mjekësore në të gjithë Republikën e Moldavisë. Dhurimi iu dorëzua Sekretarit të Shtetit të Ministrisë së Shëndetësisë, Punës dhe Mbrojtjes Sociale të Republikës së Moldavisë, znj. Tatiana Zatic dhe Drejtorit të Spitalit Klinik Z. Alexandru Holostenco, gjatë një ceremonie të pranishëm nga H.E. Z. Kestutis Kudzmanas, Ambasadori i Ambasadës së Kontaktit të NATO-s – Ambasada e Lituaniës.

Kjo mbështetje është shpërndarja fillestare e një pakete të ndihmës COVID-19 të NATO-s, Aleatët kanë rënë dakord t'i sigurojnë Republikës së Moldavisë. Pajisjet e tjera mjekësore duke përfshirë 100,000 maska të disponueshme FFP2 do të dorëzohen në Republikën e Moldavisë në javët e ardhshme. Blerja dhe transporti i artikujve mjekësor u koordinua nga Agjencia e Ndihmës dhe Prokurimit e NATO-s (NSPA). Kjo ndihmë është pjesë e gjashtë paketave të ndihmës COVID-19 të NATO-s për partnerët e NATO-s dhe pesë paketave të ndihmës për aleatët. Tetëmbëdhjetë aleatë kanë bërë donacione financiare dhe në natyrë të pajisjeve mjekësore dhe furnizimeve për Fondin e Mirëbesimit të Përgjigjes Pandemike.

Republika e Moldavisë është një partner i ngushtë i NATO-s. Me kërkesë të Moldavisë, NATO dhe Moldavia bashkëpunojnë për një sërë çështjesh, duke përfshirë reformën e mbrojtjes së vendit dhe përpjekjet për modernizimin. Moldavia është gjithashtu një kontribuese e vlerësuar në forcën paqeruajtëse të udhëhequr nga NATO në Kosovë. Bashkëpunimi i NATO-s me Republikën e Moldavisë është në respekt të plotë të neutralitetit kushtetues të vendit dhe me mbështetje të plotë për integritetin dhe sovranitetin e saj territorial.

Aleancë dhe bashkëpunim, Finlanda partneri më i afërt i NATO-s

Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s dhe aleatët shkëmbejnë mendime me ministrin e Jashtëm Finlandez

Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Mircea Geoană mirëpriti ministrin e Jashtëm finlandez Pekka Haavisto në Selinë e NATO-s (24 shkurt 2021) për të diskutuar çështje të përbashkëta të sigurisë dhe mundësitë për bashkëpunim të mëtejshëm. Ministri i Jashtëm finlandez gjithashtu mori pjesë në një takim të Këshillit të Atlantikut të Veriut.

Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm tha se Finlanda është një nga partnerët më të afërt të NATO-s dhe falënderoi ministrin e Jashtëm finlandez për marrëdhëniet e shkëlqyera të ndërtuara mbi një themel të vlerave të përbashkëta, besimit dhe interesave të përbashkët të sigurisë.


Z. Geoană shprehu vlerësimin e tij për ministrin e Jashtëm për kontributet e Finlandës në sigurinë



ndërkombëtare, për shembull, duke marrë pjesë në misionet dhe operacionet e drejtuara nga NATO në Afganistan, Irak dhe Kosovë. Ai vlerësoi punën e Qendrës Evropiane të Ekselencës Kundër Kërcënimeve Hibride me qendër në Helsinki. Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm gjithashtu mirëpriti ekspertizën e Finlandës në qëndrueshmërinë dhe gatishmërinë civile.

Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm dhe ministri Haavisto dis-

kutuan përfitimet e ndërsjella të partneritetit NATO-Finlandë dhe ranë dakord mbi nevojën për të vazhduar punën ngushtë për një sërë çështjesh, duke përfshirë sigurinë në rajonin e Detit Baltik dhe luftën kundër kërcënimeve hibride. Ata gjithashtu shkëmbyen mendime mbi iniciativën NATO 2030 për të forcuar Aleancën për të ardhmen, bashkëpunimin NATO-BE dhe ndikimin e ndryshimit të klimës në mjedisin e sigurisë, veçanërisht në Veriun e Lartë.



Disiplina dhe kultura institucionale e kultivuar me standardet më të larta ushtarake, kanë bërë që Kosova të konsiderohet një faktor i rëndësishëm për paqen dhe sigurinë në nivel ndërkombëtar. Edhe pak ditë na ndajnë, kur trupat tanë do t'i bashkohen ushtrisë amerikane për të kontribuar në misionin e parë historik paqeruajtës ndërkombëtar.




Ministri Quni; puna e palodhshme e radhit FSK-në në vendin e parë

FSK ndërton urën mobile “Mabey Johnson” e cila do lidhë 11 fshatra

Ura „Mabey Johnson” ka një gjatësi prej 36.58 metra dhe gjerësi 4.5 metra, me kapacitet të peshës prej 40-80 ton. Kjo urë ka rëndësi të madhe për banorët e kësaj ane pasi lidhë 11 fshatra

Në fshatin Hajnoc të Komunës së Kamenicës, u përruar ura mobile Mabey Johnson” e ndërtuar nga Forca e Sigurisë së Kosovës, pas shembjes së urës së vjetër si pasojë e reshjeve të mëdha të shiut. Në ceremoninë e përrimit të urës „Mabey Johnson” morën pjesë: ministri në detyrë i Mbrojtjes z. Anton Quni, zëvendëskomandanti i FSK-së gjeneral major Enver Cikaqi, kryetari i Komunës së Kamenicës z. Qëndron Kastrati, përfaqësues të KFOR-it amerikan, përfaqësues të Ministrisë së Infrastrukturës dhe oficerë të Xhenios të FSK-së. Shiritin e përrimit të urës e prenë ministri në detyrë z. Anton Quni, kryetari i Kamenicës z. Qëndron Kastrati dhe zv. komandanti i FSK-së, gjenerali Enver Cikaqi. Me këtë rast, ministri në detyrë z. Quni u shpreh se kjo ngjarje pasqyron vlerat që personifikojnë ushtarët e FSK-së, vlerën e humanizmit dhe solidaritetit me qytetarët. Ministri Quni, më tej tha: „Profesionalizmi, efikasiteti dhe zelli i secilit pjesëtar të ekipit të inxhinierëve, në kuadër të Regjimentit të Xhenios të FSK-së, rezultoi me përrbushjen e këtyre detyrave në afat rekord, pavarësisht kushteve të vështira klimatike, për të përrbushur njëkohësisht parimet kushtetuese dhe ligjore - mbështetjen ushtarake të autoriteteve civile.” Ai, gjithashtu shtoi se: “Puna e palodhshme e radhit FSK-në në vendin e parë, në mesin e institucioneve shtetërore, të vlerë-



suar nga qytetarët; si institucioni më i besueshëm. Disiplina dhe kultura institucionale e kultivuar me standardet më të larta ushtarake, kanë bërë që Kosova të konsiderohet një faktor i rëndësishëm për paqen dhe sigurinë në nivel ndërkombëtar. Edhe pak ditë na ndajnë, kur trupat tanë do t'i bashkohen ushtrisë amerikane për të kontribuar në misionin e parë historik paqeruajtës ndërkombëtar”. Ministri Quni po ashtu falënderoi autoritetet komunale dhe Ministrinë e Infrastrukturës, të cilat së bashku kontribuuan në rikthimin e normalitetit dhe lehtësimin e qarkullimit të lëvizjes si një domosdoshmëri për secilin.

Ndërsa, zëvendëskomandanti i FSK-së, gjeneral major Enver Cikaqi, ka përrgëzuar xhenierët e FSK-së për punën dhe angazhimin në ndërtimin e kësaj ure, e cila ka rëndësi të madhe për komunitetet që jetojnë në këtë vend. Ai, theksoi se „FSK-ja ka kapacitete për mbështetjen e autoriteteve civile dhe këtë e ka dëshmuar gjatë vërshimeve të fundit të angazhuara në njësinë e kërkim-

shpëtimin në dhjetëra raste në të gjithë Kosovën”.

Kryetari i Kamenicës, z. Qëndron Kastrati, pasi falënderoi ministrin Quni, zv. komandantin Cikaqi dhe FSK-në, për ndërtimin e shpejtë të kësaj ure, tha se „sot është një ditë e veçantë - kur po e inaugurojmë këtë urë të ndërtuar nga FSK-ja. Si gjithherë operacionet e FSK-së na bëjnë krenar. Këtë herë edhe më shumë, sepse reagan ndaj një fatkeqësie natyror me shpejtësi për të rikthyer komunikimin e fshatrave; fëmijëve, pleqve, të sëmurëve e të gjithëve pa dallim. Z. Kastrati në emër të Komunës në shenjë mirënjohjeje dhe falënderimi ndau Mirënjohje për FSK-në. Xhenierët e FSK-së këtë urë e ngritën për 9 ditë pune, edhe pse ngritja e saj ishte planifikuar për 14 ditë pune. Ura „Mabey Johnson” ka një gjatësi prej 36.58 metra dhe gjerësi 4.5 metra, me kapacitet të peshës prej 40-80 ton. Kjo urë ka rëndësi të madhe për banorët e kësaj ane pasi lidhë 11 fshatra.

Medalje dhe mirënjohje për 61 zyrtarë të MM-së dhe FSK-së

Në Ministrinë e Mbrojtjes, u organizua ceremonia e ndarjes së medaljeve dhe mirënjohjeve me rastin e shënimit të Ditës së Forcës dhe me rastin e shënimit të 13 Vjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës. Ministri i Mbrojtjes, Anton Quni ka dekoruar me medalje dhe mirënjohje 61 zyrtarë të MM-së dhe pjesëtarë të FSK-së.

Me këtë rast, Ministri Quni i përrgëzoi të gjithë zyrtarët dhe pjesëtarët e dekoruar me medalje dhe mirënjohje, për performancën e veçantë gjatë kryerjes së detyrave dhe kontributin e dhënë në arritjet e përrgjithshme të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së.

Kurse nga ana e tij komandanti i FSK-së, gjenerallejtnant Rrahman Rama falënderoi Ministrin Quni për vlerësimin dhe bashkëpunimin e ngushtë si dhe përrgëzoi të dekoruarit



duke thënë se ky vlerësim është motiv i fuqishëm për të vazhduar edhe në të ardhmen në realizimin e detyrave me profesionalizëm, përrkushtim si dhe shërbim vetëmohues. Medaljet


dhe mirënjohjet për zyrtarët e MM-së dhe pjesëtarët e FSK-së ndahen sipas legjislacionit në fuqi, respektivisht Rregullores së Ministrisë së Mbrojtjes për medalje dhe mirënjohje.

Pjesëtarë të FSK-së trajnohen në fushën e medias dhe komunikimit

Në Kazermën “Adem Jashari” të Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK) në Prishtinë, u certifikuan pjesëtarë të FSK-së, të cilët kishin marrë pjesë në trajnimin për media të realizuar nga Instituti Kosovar i Medias dhe Komunikimit (IKMK). Gjatë trajnimit, pjesëmarrësit patën mundësi që të njoftohen në fushën e medias dhe të komunikimit masiv; njohuri, këto të cilat do të mund t'i përrdorin gjatë realizimit të detyrave të tyre në FSK. Në ceremoninë e certifikimit të pranishëm ishin: Drejtori i Departamentit për Marrëdhënie me Publikun në Ministrinë e Mbrojtjes, z. Ibrahim Shala, drejtoresha Ekzekutive e IKMK-së znj. Kaltrina Ajeti, shefi i Departamentit për Operacione dhe Trajnime në Shtabin e Përrgjithshëm, kolonel Ejup Maqedonci dhe shefi i Zyrës së Informimit, nënkolonel Vëllazërim Qerimi.

KFOR-i zhvillon stërvitje me helikopterë në të gjithë Kosovën

KFOR-i ka zhvilluar ditën e enjte, më 25 shkurt 2021, një stërvitje rutinore, ku janë përrfshirë helikopterë të shumtë në të gjithë Kosovën. Në një komunikim për median të lëshuar nga zyra për informim e KFOR-it, thuhet se ushtrimi në fjalë, u përrqendrua në sigurimin e ndërveprimit ndërmjet të gjithë anëtarëve të KFOR-it dhe kombeve partnere. Kjo stërvitje realizohet në përrputhje me mandatin e KFOR-it, nga Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, të vitit 1999, për të siguruar një mjedis të qetë dhe të sigurt si dhe lirinë e lëvizjes për të mirën e të gjitha komuniteteve në Kosovë.



Memorandumi paralajmëron promovimin e partneritetit strategjik përmes trajnimeve dhe ushtrimeve të përbashkëta, promovimin e mundësive për luftën kundër terrorizmit, shkëmbimin më intensiv në arsimimin ushtarak profesional, si dhe përmirësimin e ndërveprimit. Pas nënshkrimit të Memorandumit, Shekerinska dhe Karlin ranë dakord në një bisedë telefonike se Memorandumi është një provë e angazhimit të ndërsjellë për të zhvilluar bashkëpunimin në mbrojtje në nivelin dypalësh, por edhe si vende-aleate në NATO.



Ministrja Shekerinska- Ndihmës Sekretarja e Mbrojtjes e SHBA-së Mara Karlin

Maqedonia e Veriut-SHBA: Firmoset Memorandumi i Bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes

Gjatë tre dekadave forcat e armatosura maqedonase kanë marrë nga SHBA pajisje me vlerë mbi 150 milion dollarë dhe më shumë se 800 pjesëtarë të Armatës dhe personeli i mbrojtjes janë trajnuar në shkollat e larta ushtarake amerikane



shkollat e larta ushtarake dhe qendrat e trajnimit. Një shembull i nivelit jashtëzakonisht të lartë të besimit midis ushtrive të të dy vendeve është pjesëmarrja e përbashkët në misionet paqeruajtëse, të tilla si misioni “Liria për Irakun”, misioni ISAF në Afganistan ku në operacionin special “Phoenix” trupat e ushtrisë ishin të vendosur në ekepe të bashku me pjesëtarët e Gardës Kombëtare të Vermontit, me të cilët ne kemi punuar intensivisht për 27 vjet, si dhe misionin “Mbështetje e Vendosur” i cili vazhdon. Në gjysmën e dytë të muajit maj të këtij viti, konsultimet dypalëshe të mbrojtjes do të mbahen midis ekspertëve të mbrojtjes nga Ministria dhe Pentagoni, të cilat do të jenë një mundësi tjetër për të shkëmbyer iniciativa të reja.

Ministrja e Mbrojtjes Radmilla Shekerinska dhe Ndihmës Sekretarja e Mbrojtjes e SHBA-së për Çështjet e Sigurisë Ndërkombëtare Mara Karlin nënshkruan një Memorandum të ri të Bashkëpunimit të Mbrojtjes midis Maqedonisë së Veriut dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shkup dhe Uashington. Nënshkrimi i Memorandumit në Ministrinë e Mbrojtjes u ndoq nga ambasadorja e SHBA-së, Kate Burns. Memorandumi i ri pasqyron bashkëpunimin jashtëzakonisht të ngushtë të mbrojtjes midis dy vendeve, i cili është bërë më intensiv në vitet e fundit dhe zëvendëson Memorandumin ekzistues të Bashkëpunimit, i cili u nënshkrua në vitin 1994. Memorandumi paralajmëron promovimin e partneritetit strategjik përmes trajnimeve dhe ushtrimeve të përbashkëta, promovimin e mundësive për luftën kundër terrorizmit, shkëmbimin më intensiv në arsimimin ushtarak profesional, si dhe përmirësimin e ndërveprimit. Pas nënshkrimit të Memorandumit, Shekerinska dhe Karlin ranë dakord në një bisedë telefonike se Memorandumi është një provë e angazhimit të ndërsjellë për të zhvilluar bashkëpunimin në mbrojtje në nivelin dypalësh, por edhe si vende-aleate në NATO. Në bisedë u shpreh kënaqësia për rritjen e bashkëpunimit midis Maqedonisë së Veriut dhe SHBA-së në drejtim të modernizimit dhe paisjes së Armatës, trajnimeve dhe stërvitjeve të përbashkëta, pjesëmarrjes së përbashkët në misionet e NATO-s dhe bashkëpunimit në zhvillimin e poligonit Krivollak sipas kapaciteteve të NATO-s. Në prag të 27 Marsit, ministrja Shekerinska pranoi urime nga Përfaqësuesja e Lartë e Pentagonit, Karlin, për përvjetorin e ardhshëm të anëtarësimit të Maqedonisë së Veriut në NATO.

Bashkëpunimi i mbrojtjes midis Maqedonisë së Veriut dhe Shteteve të Bashkuara është një shembull i bashkëpunimit strategjik midis dy vendeve që tani janë aleate të NATO-s. SHBA-të janë një nga mbështetësit më të mëdhenj të zhvillimit të Forcave të Armatosura maqedonase në tre dekadat e fundit. Gjatë kësaj periudhe, përmes programit të ndihmës ushtarake ndërkombëtare, forcat e armatosura maqedonase kanë marrë nga SHBA pajisje me vlerë mbi 150 milion dollarë. Më shumë se 800 pjesëtarë të Armatës dhe personeli i mbrojtjes janë trajnuar përmes trajnimeve ushtarake dhe programeve arsimore në

Kjo është një ditë e shkëlqyeshme për Armatën, për mbrojtjen maqedonase, por kjo është një ditë e shkëlqyer edhe për partneritetin tonë strategjik me SHBA-në. “Së bashku me SHBA-në dhe forcat e tyre të armatosura, planifikojmë zhvillimin e poligonit Krivollak, punojmë së bashku në zhvillimin e Krivollakut, dhe këtë pranverë ne do të vazhdojmë t’a përdorim atë së bashku si një kapacitet fenomenal, jo vetëm lokal kombëtar, por si një kapaciteti i NATO-s”, -tha ministrja Shekerinska e cila vizitoi poligonin ushtarak Krivollak së bashku me ambasadorin e SHBA-së Kate Burns, ku u njoftuan për aktivitetet e ardhshme të njësive inxhinierike nga të dy vendet që do të kontribuojnë në zhvillimin e këtij poligoni.

Ministrja Shekerinska shtoi se Batalioni i 15-të Inxhinierik i Ushtrisë Amerikane pritet të arrijë në mes të muajit të ardhshëm dhe së bashku me inxhinierët maqedonas do të vazhdojnë të punojnë në zhvillimin e poligonit.

“Kjo është një aleancë në veprim, dhe kjo tregon se së bashku ne dimë të planifikojmë, së bashku mund të investojmë në ndërtimin e Krivollakut, por me qëllimin kryesor të jemi aleatë më të mirë dhe të kryejmë stërvitje të

NJË BASHKËPUNIM ME AMERIKANËT Poligoni në Krivollak, një kapacitet potencial për NATO-n dhe Aleatët

Batalioni i 15-të Inxhinierik i Ushtrisë Amerikane pritet të arrijë në mes të muajit të ardhshëm dhe së bashku me inxhinierët maqedonas do të vazhdojnë të punojnë në zhvillimin e poligonit Krivollak

përbashkëta dhe operacione të përbashkëta luftarake”.

Ajo shtoi se realizimi i këtyre aktivitetëve është në fakt përgatitja e stërvitjes së madhe “Goditje e Vendosur - 210, në të cilën do të marrin pjesë rreth 2000 pjesëtarë të ushtrive të Maqedonisë së Veriut, SHBA-së, Greqisë, Bullgarisë. Shekerinska tha në konferencë ajo dhe ambasadorja Burns u informuan për planin për zhvillimin e poligonit për këtë vit dhe vitet e ardhshme kur do të realizohen aktivitetet të reja stërvitore, por edhe për mundësitë që do t’u ofrojnë poligoni të gjithë aleatëve që kërkojnë zona të tilla të mëdha trajnimi.


“Sot do të kemi mundësinë të shohim deri ku ka arritur puna me inxhinierët, por mendoj se mesazhi kryesor është se kur je pjesë e një

aleance të fortë si NATO dhe kur ke aleatë ku mund të mbështetesh-bëhesh më mirë.” -tha Shekerinska.

Ambasadorja amerikane, Kejti Burns, tha se ishte e impresionuar nga profesionalizmi dhe ekspertiza e ushtarëve, por edhe nga mënyra se si ata përgatiten për realizimin e stërvitjes “Goditje e Vendosur”.

“Çdo njësi amerikane që ka pasur mundësinë të stërvitet këtu në Krivollak, inxhinierët, planifikuesit, të gjitha kanë vetëm fjalë lavdërimi për potencialin e këtij poligoni dhe për aftësinë për të qenë mikpritës i stërvitjeve luftarake efektive dhe reale. Poligoni ushtarak Krivollak është një vlerë unike për Maqedoninë e Veriut, nuk është vetëm një vendndodhje për ju për të zhvilluar ushtrinë tuaj dhe përpjekjet e modernizimit dhe përgatitjen për pajisje të

reja të tilla si JLTV dhe Stryker, por gjithashtu një mundësi për të bërë stërvitje edhe më komplekse me të gjitha partnerët dhe aleatët rajonalë në NATO, përfshirë Shtetet e Bashkuara. Ne jemi të kënaqur që shohim investimet tuaja në poligon, jemi shumë të kënaqur me qasjen tuaj për mundësinë e stërvitjeve në të ardhmen, dhe kjo është një nga arsytet pse, siç tha ministrja, ne investojmë në Krivollak sepse besojmë se nuk është vetëm një mundësi e shkëlqyeshme për stërvitjen që pason dhe e cila do të jetë shumë mbresëlënëse, por gjithashtu një mundësi për zhvillim të qëndrueshëm të Krivollakut që do ta mundësojë të përdoret për operacione dhe stërvitje komplekse rajonale në të ardhmen”, -tha ambasadorja amerikane Burns.



Injac theksoi veçanërisht rëndësinë e pjesëmarrjes së avionëve ushtarakë grekë në zbatimin e mbrojtjes së hapësirës ajrore të Malit të Zi përmes Policimit Ajror, si dhe trajnimin e oficerëve të ardhshëm të VCG në akademitë ushtarake Greke. Ajo gjithashtu theksoi rëndësinë e mbështetjes së vazhdueshme Greke për integrimin europian të vendit tonë.



MINISTRJA OLIVERA INJAC-AMBASADORI PANAYOTIS PARTSOS

Mali i Zi-Greqi: Bashkëpunim brenda aleancës së NATO-s

Do të intensifikohet bashkëpunimi dinamik në fushën e mbrojtjes, përmes zbatimit të aktiviteteve dypalëshe dhe aleate

Ministrja e Mbrojtjes, prof. Dr. Olivera Injac, priti Ambasadorin e Republikës Greke në Malin e Zi Panayotis Partsos. Ministrja Injac shprehu kënaqësinë për bashkëpunimin intensiv të aleatëve brenda aleancës së NATO-s, duke theksuar se Mali i Zi do të vazhdojë të promovojë vlerat Euro-Atlantike, me mirënjohje për mbështetjen që Greqia i dha Malit të Zi në rregullimin shumë kërkuar të sektorit të saj të mbrojtjes gjatë procesit të anëtarësimit në NATO. Injac theksoi veçanërisht rëndësinë e pjesëmarrjes së avionëve ushtarakë grekë në zbatimin e mbrojtjes së hapësirës ajrore të Malit të Zi përmes Policimit Ajror, si dhe trajnimin e oficerëve të ardhshëm të VCG në akademitë ushtarake Greke. Ajo gjithashtu theksoi rëndësinë e mbështetjes së vazhdueshme Greke për integrimin europian të vendit tonë.

Me kënaqësinë që këtë vit shënon njëqind e dyzet vjetorin e marrëdhënieve diplomatike midis Malit të Zi dhe Republikës së Serbisë. Ambasadori Partsos theksoi miqësinë tradicionale të të dy vendeve, të cilat ndajnë një vizion të përbashkët të stabilitetit dhe prosperitetit në rajonin e Ballkanit, Mesdheut dhe



në të gjithë Evropën. Ambasadori vlerësoi bashkëpunimin kuptimplotë dhe dinamik në fushën e mbrojtjes, duke besuar se do të intensifikohet

në periudhën e ardhshme përmes zbatimit të aktiviteteve dypalëshe dhe aleate. Gjatë takimit, bashkëbiseduesit shkëmbyen mendime

mbi situatën aktuale politike dhe të sigurisë në rajon, çështjet e bashkëpunimit dypalësh, si dhe bashkëpunimin brenda NATO-s, duke thek-

suar nevojën për lidhje edhe më të ngushta dhe veprime të përbashkëta, duke pasur parasysh kompleksitetin e sigurisë moderne sfidat.

MINISTRJA INJAC-AMBASADORI GANDEL

Mali i Zi-Slovakia: Bashkëpunim dypalësh në fushën e mbrojtjes

Ministrja Injac tha se Mali i Zi dhe Sllovakia, si dy vende miq, ndajnë vlerat e përbashkëta Euro-Atlantike dhe Europiane, duke shtuar se përparësitë e politikës së jashtme të Malit të Zi mbeten të pandryshuara, me një theks në zbatimin e suksesshëm të agjendës së integritetit europian. Injac veçanërisht falënderoi Sllovakinë për mbështetjen e saj të fortë dhe të vazhdueshme për proceset e integritetit të Malit të Zi.

Ministrja shprehu kënaqësinë me bashkëpunimin e tanishëm dypalësh për mbrojtjen dhe vuri në dukje se përmes shkëmbimit të përvojës, aftësive dhe njohurive në fushën e mbrojtjes dhe pjesëmarrjes së përbashkët në ushtrime bilaterale dhe aleate, ajo pret një vazhdim të suksesshëm të bashkëpunimit.

Ambasadori Gandel theksoi marrëdhëniet miqësore midis dy vendeve, si dhe gatishmërinë e Sllovakisë për të ndihmuar Malin e Zi të përshpejtojë reformat në rrugën drejt integritetit

europian. Ambasadori deklaroi se Sllovakia dhe Mali i Zi, si aleatë të NATO-s, ndajnë të njëjtat vlera dhe interesa në kontekstin e sigurisë europiane.




Një e drejtë studimi në Akademinë Ushtarake të Ushtrisë Italiane

Ministria e Mbrojtjes ka bërë publike shpallje për zgjedhjen e kadetëve për arsim në Akademinë Ushtarake në Republikën e Italisë. Duke filluar nga viti i studimit 2021-2022, një vend është hapur në Akademinë Ushtarake të Ushtrisë Italiane, specialiteti këmbësori, në Modena. Në fillim të arsimit në akademitë ushtarake, kandidati i përzgjedhur fiton titullin kadet, dhe pas mbarimit të arsimit pranohet në shërbim në Ushtrinë e Malit të Zi, pa njoftim publik, në gradën fillestare të oficerit.

Teksti i parashikon të drejta dhe detyrimet e përgjithshme por edhe të veçanta të kadetëve, si dhe formularin e aplikimit i cili mund të gjenden në faqen e internetit të Ministrisë së Mbrojtjes. Shpallja publike është e hapur deri më 25 mars. Dokumentacioni i aplikimit dërgohet në adresën-Ministria e Mbrojtjes, Drejtoria për Burimet Njerëzore, Çështjet e Personelit dhe Statusit, Rruga Jovana Tomaševića nr. 29, Podgorica, me shënimin "Për njoftim publik për arsimim në Akademinë Ushtarake të Ushtrisë në Republikën e Italisë".





“Falë veprimtarisë së komandantëve të Forcave Ajrore dhe iniciativës së menaxhimit të bazës ajrore, u lidh një kontratë për riparimin e 8 prej avionëve ekzistues Su-25 dhe sot i shihni gati. Kishte shumë skeptikë që shpjeguan se nuk kishim nevojë për aeroplanë rusë, nuk kishim nevojë për aeroplanë të vjetër. Unë gjithmonë kam thënë - nuk ka avionë rusë, për sa kohë që paguhen nga shtetasi bullgar, këto janë avionë bullgarë dhe ata kryejnë misione për të mbrojtur integritetin territorial dhe sovranitetin e Bullgarisë”, - tha Ministri Karakachanov.



Ministri Krassimir Karakachanov

Riparimi i avionëve SU-25K në përputhje me aviacionin e NATO-s

Mbi bazën e kontratës, kostoja e riparimit të 8 avionëve S-25 është 42 milionë euro

Ministri i Mbrojtjes Krassimir Karakachanov personalisht kontrollon aftësitë e avionëve të riparuar Su-25 në bazën e vendosjes së frontit në “Bezmer” dhe ishte i bindur për aftësitë e tyre luftarake. Më datë 26 shkurt, me Ministrin e Mbrojtjes në bord u krye një fluturim me një nga avionët e riparuar Su-25.

“Dy vjet më parë, ne ishim ballafaquar me perspektivën për të mos pasur një aeroplan të vetëm Su-25, i cili është avioni kryesor luftarak për mbështetjen e Forcave Tokësore dhe të Marinës. Falë veprimtarisë së komandantëve të Forcave Ajrore dhe iniciativës së menaxhimit të bazës ajrore, u lidh një kontratë për riparimin e 8 prej avionëve ekzistues Su-25 dhe sot i shihni gati. Kishte shumë skeptikë që shpjeguan se nuk kishim nevojë për aeroplanë rusë, nuk kishim nevojë për aeroplanë të vjetër. Unë gjithmonë kam thënë - nuk ka avionë rusë, për sa kohë që paguhen nga shtetasi bullgar, këto janë avionë bullgarë dhe ata kryejnë misione për të mbrojtur integritetin territorial dhe sovranitetin e Bullgarisë,”-tha Ministri Karakachanov.

Ai shpjegoi se pas punëve për riparimin dhe restaurimin, avionët janë plotësisht në përputhje me aviacionin e NATO-s dhe të gatshëm për të kryer detyra në çdo kohë të ditës. “Shumë vite më parë ne nuk kishim tetë aeroplanë në gatishmëri luftarake,” -komentoi Ministri Karakachanov.

Ai falënderoi Zëvendës Ministrin Anatoli Velichkov, i cili drejtoi projektin për të riparuar avionët sulmues. “Në 6-7 vitet e fundit, fondet janë



alokuar për infrastrukturën e bazës ajrore “Bezmer”. Falë politikës së Ministrisë së Mbrojtjes, tani nuk ka asnjë problem në bazë dhe as mungesë të personelit ushtarak, të gjitha pozicionet ushtarake janë mbushur. Jam i lumtur dhe jam i bindur që kur të largohemi, do të lëmë komandantin e Forcave Ajrore dhe oficerët e aviacionit shumë më të sigurt në të ardhmen e saj”, -tha Ministri i Mbrojtjes.

Riparimi i 8 avionëve Su-25K/UBK, motorëve 16 R-95S, dërgë-

save të pjesëve rezervë, pajisjeve, dokumentacionit dhe zëvendësimit të sistemeve dhe njërive vlen 42 milione euroeuro pa TVSH sipas një kontrate më datë 14 dhjetor 2018. Sistemi i navigimit i Su-25 është modernizuar plotësisht për të përfshirë aftësitë e lundrimit satelitor. Kjo siguron vetëdije më të madhe të informacionit për pilotin. Mundësitë për përdorimin e armëve raketore janë zgjeruar ndjeshëm. Radiot janë zëvendësuar me ato të reja, të cilat lejojnë lidhje

dhe dëgjim të njëkohshëm në dy frekuenca dhe kontakt me një komponent tokësor dhe detar. Su-25-të e riparuar janë më të gatshme për luftime dhe shumë herë më efektive në kryerjen e detyrave kryesore të ofrimit të mbështetjes së menjëhershme të aviacionit për formacionet e njërive tokësore dhe detare. Funkcionimi i avionëve të riparuar do të sigurojë të ardhmen e bazës ajrore në “Bezmer” dhe rritjen e aftësive luftarake të Forcave Ajrore.

Rishikohet ligji për Forcat e Armatosura të Bullgarisë

Më 26 shkurt, Asambleja Kombëtare miratoi Projektligjin për ndryshimin e ligjit “Për Mbrojtjen dhe Forcat e Armatosura të Republikës së Bullgarisë (ZOVSRB)”, paraqitur nga Këshilli i Ministrave më 17 shkurt 2021. Projektligji rregullon përmirësimin e strukturës organizative të Forcave të Armatosura, transformimin e sistemit të komandës dhe kontrollit dhe mbështetjen logjistike të Forcave të Armatosura. Kjo bazohet në rezultatet e rishikimit të Strategjisë së Mbrojtjes dhe në Programin për Zhvillimin e Aftësive Mbrojtëse të Forcave të Armatosura deri në vitin 2032. Krijohen dy struktura të reja brenda ushtrisë bullgare: Komanda për Mbështetjen Logjistike dhe Komanda për Komunikim dhe Mbështetje të Informacionit dhe Mbrojtjen Kibernetike. Kompetencat e Shefit të Mbrojtjes, në lidhje me udhëheqjen e drejtpërdrejtë të komandantëve të komandave të tre llojeve të forcave të armatosura, gjithashtu po zgjerohen. Shefit të Mbrojtjes i janë caktuar përgjegjësitë për zhvillimin e planeve të veprimit të Forcave të Armatosura, aktivizimin e forcave dhe zbatimin e një plani specifik.

Në fillim të pranverës, baza ajrore filloi pjesëmarrjen aktive në trajnimin kombëtar dhe ndërkombëtar të fluturimit. Me investimet e bëra, aeroporti ushtarak “Bezmer” plotëson të gjitha standardet moderne dhe ka aftësinë për të kryer stërvitje dhe trajnime fluturimi me forcat ajrore të vendeve anëtare të NATO-s, dhe mund të përdoret në të ardhmen si një aeroport rezervë F-16 për nevojat e Forcës Ajrore Bullgare.

Kontingjenti i 42-të i forcave të armatosura mori vlerësimin “Boegot”

Kontingjenti i 42-të i forcave të armatosura mori vlerësimin “Boegot” për pjesëmarrjen në misionin e NATO-s “Mbështetje Vendimtare” në Afganistan.

Ekzaminimi i nivelit të trajnimit, aftësive të komandës dhe personelit të caktuar për të kryer detyra gjatë misionit të ardhshëm u krye nga një komision i Komandës së Forcës së Përbashkët. Ky është certifikimi i parë i një formacioni ushtarak nga Forcat e Armatosura të Republikës së Bullgarisë, i kryer



në përputhje me kërkesat e standardeve të reja për forcat e Komandës Aleate për operacionet e NATO-s.

Komisioni, i kryesuar nga kolonel Julian Petrov, Shef i Departamentit të Trajnimit të Përbashkët në SCS, vlerësoi aftësitë luftarake të kontingjentit të 42-të për pjesëmarrjen në misionin e NATO-s në Afganistan. Gjatë dy ditëve në Qendrën e Trajnimit “Marino Pole”, ushtarakët demonstruan

aftësitë e tyre në stërvitjen taktike-speciale: “Veprimet e kompanisë në ruajtjen e bazës”. Kontingjenti 42-të i sigurishtëkomandohet nga Majori Milen Prodanov dhe përfshin ushtarakë nga formacionet e Brigadës 61 të Mekanizuar të Forcave Tokësore. Detyrat që kompania supozohet të kryejë në Afganistan kanë të bëjnë me sigurinë e një pjese të perimetrit të brendshëm të bazës së Aeroportit “Bagram”, ndërrimet e detyrës në qendrën e operacioneve të bazës, etj.



PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

Prezantim rreth autorit

Libri është shkruar nga Jovan M. Bizhyti, i cili ka lindur në Kolonjë të Myzeqesë. Pasi ka përfunduar gjimnazin në qytetin e Lushnjës, ka vijuar arsimin e lartë në degën Histori-Gjeografi, në Universitetin Shtetëror të Tiranës. Në vitin 1979-1980 ka kryer specializim pasuniversitar për filozofi. Ndërsa në vitin 1976, pranohet anëtar i Lidhjes së Shkrimtareve dhe Artistëve të Shqipërisë.

Libra të botuara prej autorit janë: “Gjurmë të një arratie”, “Stina e divorceve” dhe “Piramida dhe fundi i një dashurie”-romane; “Historia e një romeje” dhe “Rrëfimi i një zonje”-novela; “Trokitje e vonuar”-vëllim poetik; “Historiku i LANÇ-it të rrethit të Lushnjës” 2005; “Kolonja në sofrën myzeqare”, (historiku i fshatit), 2008; “Xhorxhi Robo, një jetë me histori”, monografi, viti 2009; “Historia e Manastirit të Ardenicës, tempullit shenjtëruës ortodoks”, 2017, “Gjeneral Spiro Moisiu” 2020, si dhe botime historike në shtypin e ditës e atë periodik.

Shkrimtari, prozatori, poeti, si dhe studiuesi e biografi, Jovan M. Bizhyti, studioi dhe bëri librin për jetën dhe kontributin e Gjeneral Spiro Moisiut. Autori në çdo faqe të librit, me ndjenja dhe emocione na ka dhënë patriotin, progresistin, konseguent, ushtarakun e betejave luftarake dhe gjeneralin e talentuar në përballjen e madhe, në LANÇ-in që solli çlirimin e vendit. Autori me punën plot pasion e përkushtimin, me përvojë si krijues i talentuar dhe me kontributin si studiues, ka realizuar një monografi dhe na paraqet të plotë figurën e Gjeneral Moisiut. Në monografi janë harmonizuar në një lidhje kritere teknike me kronologjike dhe është paraqitur e plotë figura e Gjeneral Moisiut gjithnjë në rritje përmes ngjyrash e situatash dhe veprimtarisë së tij të gjithanshme dhe intrasigjente. Pena e shkrimtarit na ka dhënë botën shpirtërore, karakterin e heroit, një rrëfim të rrjedhshëm, të qartë, të besueshëm, me referenca dhe me fjalë të thjeshta. Kjo monografi na jep të plotë figurën e një ushtaraku, të një gjenerali dhe të një komandanti lufte, ky është një kontribut i çmuar në fushën ushtarake, si dhe në letërsinë biografike.


Personalitete me përmasa kombëtare

Fisi i Moisiu në historinë moderne të Shqipërisë, që nis pas shpalljes së Pavarësisë, zë një vend krejt të veçantë. Nga ky fin dolën personalitete të shquara, në fushën e artit skenik, por dhe në fushën e artit ushtarak dhe të strategjisë ushtarake, si dhe në armë të xhenios dhe të presidencës shqiptare. Fisi i Moisiu krenohet se i dha Shqipërisë artistin më famë botërore, Aleksandër Moisiun, ushtarakun dhe Gjeneral Spiro Moisiun, si dhe presidentin e vendit Alfred Moisiun, etj. Fisi i dëgjuar i Moisiu origjinën e kanë nga Kavaja, qytet i Shqipërisë së Mesme, me histori e tradita patriotike. Madhështia e fisit doli jashtë kufijve të Shqipërisë, me Aleksandër Moisiun, që në çdo skenë të Europës e jashtë saj shpalosi talentin e tij, duke mbetur një artist shqiptar e një pasardhës i denjë i Moisiu të Kavajës, që i dha emër Shqipërisë. Fisi i Moisiu, nxorri dhe personalitete, që u bënë të njohur në hapësirat shqiptare, në fushën e artit ushtarak, por dhe të strategut ushtarak si Gjeneral Spiro Moisiu, atdhetar i dëgjuar i Kombit Shqiptar, për të vijuar më tej me ushtarakun xhenier

Libër për Komandantin e Shtabit të Përgjithshëm të UANÇSH

Gjenerallejtënant Spiro Moisiu
në 250 faqet e një libri

Kushtuar gjenerallejtënant Spiro Moisiut në 120 vjetorin e lindjes



dhe presidentin e vendit Alfred Moisiu.

Ushtarak karriere i ushtrisë shqiptare

Në monografi Gjeneralin Spiro Moisiu, autori me të drejtë e vendos në periudhën midis Rilindjes Kombëtare që solli Pavarësinë e Shtetit Shqiptar, Monarkisë dhe më pas, zgjimit të ndërgjegjes kombëtare për çlirimin e vendit nga pushtuesit nazi-fashistë. Në këtë të fundit kontributi i tij u shtri në kohë në periudhat më të vështira që kalonte vendi i ynë në fillimet e shek. XX. Gjeneral Spiro Moisiu ka qenë protagonist në tre periudha të rëndësishme me vlera kombëtare për fatet e vendit: në periudhat e monarkisë Zogolliane, të pushtimit nazi-fashist të Shqipërisë dhe të LANÇ-it dhe në sistemin komunist, pas çlirimit të vendit. Në këto periudha të sistemeve të ndryshme politike, Gjeneral Spiro Moisiu ka shërbyer si ushtarak karriere i ushtrisë shqiptare, ka punuar e luftuar në mbrojtje të territoreve të vendit, të lirisë e pavarësisë së Atdheut dhe të forcimit të ushtrisë sonë kombëtare. Populli shqiptar pavarësisht sistemeve politike, edhe kur s'kishte ushtrinë e tij të organizuar, ka luftuar me çeta dhe grupime të ndryshme patriotësh luftëtarë për lirinë e pavarësinë e vendit.

Kontributi i patriotit dhe ushtarakut Spiro Moisiu, sipas këtyre periudhave u shqua në krijimin dhe drejtimin e njësive të Forcave të Armatosura të ushtrisë shqiptare në vitet 1921-1939; drejtues ushtarak i formacioneve luftarake dhe Komandant i Shtabit të Përgjithshëm të UPVNÇSH në vitet e luftës partizane për çlirimin e vendit, 1942-1944, si dhe krijues e modernizues i Ushtrisë Kombëtare Shqiptare pas çlirimit të vendit në vitet 1944-1947, në detyrën e Shefit të Shtatmadhorisë së Ushtrisë Shqiptare. Ai ishte udhëheqës dhe ushtarak i lartë me gradën “Major” dhe më pas “Gjeneralmajor” i LANÇ-it. Spiro Moisiu në karrierën e tij ka shërbyer mbi 60 vjet, kryesisht në shërbimin ushtarak dhe renditet nga figurat e pakta ushtarake për jetëgjatësi në detyra ushtarake, punë dhe kontribute në shërbim të popullit dhe të Atdheut.

Sfidoi si luftëtar, komandant e strateg në 6 luftëra

Gjeneral Spiro Moisiu sfidoi me dinjitet si luftëtar, komandant e strateg në 6 luftëra për mbrojtjen e trojeve e të pavarësisë së vendit.

Në vitin 1920 në luftë kundër ushtrisë serbe, e cila kishte depërtuar në territoret shqiptare deri në Kaptinë të Martaneshit. Ushtaraku i ri Spiro Moisiu ishte nga pionierët e parë që u përgatit dhe u afirmua në perëndim në shkollat e Austrisë. I brumosur me ideale patriotike dhe progresiste, erdhi në Atdhe për t'i shërbyer popullit të tij me përkushtim, sipas interesave dhe nevojave të shtetit të ri shqiptar, duke u ndeshur në përballjen e parë në përpjekje për të mbrojtur trojet e vendit të tij.

Beteja tjetër ishte kundër forcave bjellogardiste dhe bajraktare në vitin 1924, pranë fshatit Xibër të Matit dhe deri në shkallën e Tujanit në afërsi të Tiranës.

Në vitin 1926 luftoi për shtypjen e rebelimit në zonën e Dukagjinit.

Në vitin 1939 luftoi kundër pushtuesve fashistë italianë që pushtuan Shqipërinë, duke marrë pjesë në rezistencën popullore në territoret e Shëngjinit, Lezhës e Shkodrës, për shkak se Mbreti Zog dhe qeveria e tij, braktisën Shqipërinë, duke lënë popullin dhe ushtrinë në mëshirë të fatit.

Në vitin 1940 në Luftën Italo-Greke, Major Spiro Moisiu dha shembullin më patriotik dhe atdhetar, duke tërhequr nga fronti i luftës batalionin “Tomorri” që drejtohte me ushtarë shqiptarë, për t'iu shmangur çdo konflikti kundër popullit fqinj grek, për llogari të pushtuesve fashistë italianë.

Në vitet 1942-1944, në LANÇ për çlirimin e Shqipërisë, Major Spiro Moisiu dha kontributin e tij maksimal, për organizimin dhe drejtimin e formacioneve ushtarake partizane, në detyrën e lartë të Komandantit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Antifashiste NÇ.

Në të gjitha këto luftëra e betejat, Gjeneral Spiro Moisiu shpalosi vlera atdhetare dhe guximin patriotik. Ai u gjend kudoherë në mbështetje të popullit dhe Atdheut, në mbështetje të lirisë e demokracisë, duke mbajtur gjithmonë anën e progresit

Shtabi i Përgjithshëm udhëhoqi si një organ kolegjal

Major Spiro Moisiu u shqua në LANÇ-in në vitet 1943-1944, si Komandant i Shtabit të Përgjithshëm të UANÇSH, duke sakrifikuar familjen, pasurinë e gjithçka, të cilën e vuri totalisht në shërbim të Atdheut e të popullit të tij, si dhe të Luftës Antifashiste deri në çlirimin e plotë të Shqipërisë. Roli i Shtabit të Përgjithshëm për drejtimin politik e ushtarak të LANÇ-it, është vlerësuar dhe nga personalitetet e Aleatëve të Koalicionit Ndërkombëtar që udhëhoqën Luftën e Dytë Botërore, duke e vlerësuar dhe mbështetur në maksimum këtë luftë, po ashtu dhe drejtuesit e saj. Ishte meritë e PKSH me Enver Hoxhën në krye, që në momente të rëndësishme historike, arritën të tërheqin në radhët e Frontit NÇ

nacionalistë të spikatur, ndër ta dhe Major Spiro Moisiun, të cilët jo vetëm bënë për vete masën më të madhe të popullit për në betejat e luftës partizane, por dhe u prinë atyre në ballë si udhëheqës e komandant ushtarak. Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë me drejtuesit kryesor të tij e me patriotët e tjerë nacionalistë të Frontit NÇ, kanë meritën që e bënë Shqipërinë dhe LANÇ-in pjesë të Koalicionit Fitimtar të Aleancës Botërore kundër bishës nazi-fashiste, që çoi në fitoren përfundimtare, çlirimin e plotë të Shqipërisë në 29 nëntor 1944.

Luftën e armatosur Shtabi i Përgjithshëm i UNÇSH-së e udhëhoqi kudoherë si një organ kolegjal. Kështu në urdhërin e lëshuar nga Shtabi i Përgjithshëm më 17 gusht 1943 mbi strukturën organizative në UNÇSH-së, ky kriter gjen shprehjen e vet, ku theksohej se Ushtria Nacionalçlirimtare Partizane dhe Vullnetare vihet nën komandën e Shtabit të Përgjithshëm. Organet e larta, Komanda e Shtabit të Përgjithshëm, kishte kompetenca të gjëra lidhur me përpunimin e planeve strategjike e operative, dhe këto njëkohësisht merrnin vendime të rëndësishme për problemet kryesore të luftës së armatosur e të përsosjes organizative të UNÇSH-së. Në plotësimin të këtyre detyrave, komanda gjithmonë bashkëvepronte me disa nga anëtarët e tjerë të Shtabit, që gjendeshin dhe qëndronin pranë tij.

Shtabi operativ në strukturën e Shtabit, luante dhe kishte rol tepër të rëndësishëm. Ky shtab operativ gjithmonë përbëhej nga komandanti dhe komisari, si dhe dy specialistë ushtarakë. Specialistë ndiqnin situatat luftarake në shkallë vendi, i raportonin Shtabit në bazë të planeve e ideve të tij, si dhe hartoheshi urdhëra operacione e udhëzime. Nëpërmjet veprimtarisë të këtij Shtabi Operativ, bëhej i mundur drejtimi operativ-strategjik i UNÇSH-së dhe i formacioneve të saj. Ndërsa seksionet si komisarati ekonomik, seksioni i brendshëm dhe ai i shëndetësisë drejtoheshin e kishin në krye një anëtar Shtabi. Ndërsa shumica e anëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm mbanin dhe kryenin funksione komanduese në formacionet të ndryshme të UNÇSH-së.

Shtabi i Përgjithshëm i UNÇSH-së nuk ishte strukturë e rëndë. Në vetvete ai ishte një aparat i lehtë, i gatshëm për lëvizje e manovrim të shpeshta, i përshtatshëm terrenit malor dhe natyrës të luftës partizane. Shumë nga anëtarët e Shtabit komandonin formacione partizane. Edhe ata anëtarë të Shtabit të cilët nuk kishin funksione komanduese, shpesh gjendeshin pranë formacioneve të mëdha të UNÇSH-së, në detyrën e të deleguar të tij, gjatë operacioneve luftarake. Në çdo vendqëndrim të Shtabit gjatë luftës gjendej komanda dhe dy deri në tre anëtarë të tij. Në këtë mënyrë Shtabit paraqet një tipar të theksuar operativ, gjë që e rriste shumë efektivitetin e veprimit të tij.

Shtabi i Përgjithshëm, në varësi nga zhvillimi i situatave, gjithmonë synonte të ndodhej e të gjendej në afërsi të ngjarjeve e të operacioneve të rëndësishme luftarake. Gjatë luftës ai manovroi kryesisht në zonat e Shqipërisë së Mesme dhe deri në Jug të ven-

dit. Vende të përshtatshme gjithmonë janë vlerësuar krahinat malore të cillat ishin shëndërruar në baza të fuqishme të luftës partizane. Në periudhën korrik 1943-gusht 1944, vendet e qëndrimit e të drejtimit të Shtabit të Përgjithshëm ishin Çermenika (Labinoti, Shmili, Orenja), Kucaka, Panariti, Helmesi, Odriçani. Fundshtatori 1944, Shtabi i Përgjithshëm u përqëndrua në qytetin e lirë të Beratit, nga ku drejtoi operacionet mësimëse për çlirimin e plotë të vendit.

Spiro Moisiu, Komandant i Shtabit

Në këtë kohë Spiro Moisiu ishte 40 vjeç. Në këtë detyrë, ai erdhi si një ushtarak e me një karriere të gjatë e të respektuar ku spikatën aftësia e profesionalizmi ushtarak, si dhe dinjiteti e atdhedashuria. Spiro Moisiu, patriotizmin dhe shpirtin human e kishte shpalosur në rininë e hershme, në mbrojtje të punimeve të Kongresit të Lushnjës 1920, ku zë fill dhe karriera e tij ushtarake. Merr pjesë në Revolucionin e Qershorit 1924. Ndërsa pushtimi fashist e gjen me gradën ushtarake major. Ai kishte kryer një kurs për oficerë madhorë, me detyrë komandant batalioni në zonën e kufirit Shkodër-Shëngjin. Ai ishte ndër oficerët që e pritën agresionin me pushkë. U vlerësua shumë si ushtarak dhe atdhetar gjatë Luftës Italo-Greke. Meaktin e tij antifashist, liridashës e guximtar braktis frontit së bashku me batalionin që komandonte. Pasi del nga kampi i përqendrimit në Shijak, merr pjesë aktive në LANÇ. Ai i manifestoi aftësitë e tij komanduese në organizimin dhe drejtimin e formacioneve partizane në rrethin e Lushnjës. I edukuar me ndjenjat e atdhedashurisë, i shquar në veprimtarinë patriotike e me përvojë të gjatë në karrierën ushtarake, i matur e burrëror, Spiro Moisiu përfaqësoi kandidaturën më të gjetur në detyrën e Komandantit të Shtabit të Përgjithshëm. Në krye të këtij Shtabi, majori Moisiu shfaqti më tej aftësitë e tij në fushën e artit ushtarak dhe të drejtimit operativ-strategjik në kushtet e një lufte popullore, duke merituar me të drejtë nderimin dhe respektimin e efektivave dhe të komandantëve të UNÇSH-së.

Ai me qetësinë dhe ekuilibrin e admirueshëm ndërtoi marrëdhënie korrekte me të gjithë anëtarët e shtabit. Ai ishte njohës i thellë i çështjeve ushtarake dhe shfaqti kudo ndihmesën e tij të madhe në funksionimin e Shtabit të Përgjithshëm. Duke iupërshtatur natyrës së luftës, si një profesionist i aftë ushtarak e një ndër hartuesit kryesor të urdhërave, udhëzimeve e instruksioneve që nxirrte Shtabi i Përgjithshëm, ka vlerat e tij të mëdha për fuqizimin e UNÇSH-së e shëndrrimin gradual të saj nga lufta partizane në një ushtri të rregullt. Jeta dhe veprimtaria shumëvjeçare e këtij personaliteti për kauzën e mbrojtjes dhe pavarësisë së Atdheut, është trashëgimia më e vyer që ai na ka lënë dhe që gjithë brezat e shqiptarëve do i jenë mirënjohës për jetë.

577 Vjetori i Besëlidhjes së Lezhës

PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

Kuvendi u mblodh mbi bazën e traditave

Për zgjidhjen e detyrës historike të bashkimit të popullit shqiptar dhe të klasës feudale në një front të vetëm antiosman, Skënderbeu organizoi mbledhjen e një kuvendi të përgjithshëm kombëtar. Për këtë qëllim në mënyrë paraprake u zhvilluan një sërë konsultimesh me feudalët shqiptarë dhe krerët e tjerë të vendit për përgatitjen e Kuvendit dhe largimin e pengesave në rrugën e bashkimit. Kuvendi u mblodh më 2 Mars 1444 në qytetin e Lezhës që ishte nën sundimin e Venedikut. Thirrja e kuvendit në qytetin e Lezhës kishte për qëllim të evitonte çdo keqkuptim midis pjesëmarrësve, lidhur me respektimin e ndereve feudale. Nga ana tjetër siguronte përkrahjen ose të paktën neutralitetin e Venedikut në luftën e madhe shqiptaro-osmane. Kuvendi i Lezhës mblidhej mbi bazën e traditave më të hershme shqiptare, për t'i trajtuar problemet e rëndësishme në kuvende të përbashkëta. Në punimet e Kuvendit të Lezhës morën pjesë përfaqësuesit e familjeve më të fuqishme feudale shqiptare. Sundimtarë të principatave feudale ishin të pranishëm në Kuvend, të shoqëruar nga djemtë ose nga nipërit e tyre. Në të morën pjesë dhe feudalë më të vegjël si dhe krerë të tjerë, të cilët përfaqësonin fshatarësinë e lirë të malësive të Shqipërisë.

Bashkëkohësi dhe historiani i Skënderbeut, humanisti shqiptar Marin Barleti, në veprën “Historia e Skënderbeut” përshkruan emrat e sundimtarëve shqiptarë që morën pjesë në punimet e kuvendit. Midis tyre ishte nismëtari dhe organizuesi i Kuvendit, Gjergj Kastrioti Skënderbeu, si përfaqësues i principatës së Kastriotëve, Gjergj Araniti, Andrea Topia me dy djemtë, Komini dhe Muzaka me të nipin Tanush Topia, Gjergj Stres Balsha, Tedor Korona Muzaka me të tjerë nga familja e Muzakajve, Pal dhe Nikollë Dukagjini, Lekë Zaharia, Pjetër Spani me katër djemtë, Lekë Dushmani së bashku me disa feudalë më të vegjël pranë principatës së tij, etj. Pjesëmarrësit në kuvend u mblodhën nga trevat ku flitej gjuha shqipe. Përfashtim bënte vetëm Stefan Cernojeviçi, sundimtar i Zetës (Malit të Zi), që kishte zotërimet e veta pranë liqenit të Shkodrës me një popullsi të madhe shqiptare, por dhe lidhje familjare me Skënderbeun, se ishte martuar me njërin nga motrat e tij. Në Kuvendin e Lezhës mori pjesë dhe përfaqësuesi i Venedikut me cilësinë e vëzhguesit. Republika e Raguzës refuzoi të merrte pjesë për të mos ndërlikuar marrëdhëniet e saj me Sulltanin e Perandorisë Osmane.

Besëlidhja e feudalëve shqiptarë

Mbas diskutimeve të shumta, Kuvendi i Lezhës mori vendime të rëndësishme, të cilat përcaktuan natyrën politike të këtij kuvendi. Me gjithë divergjencat e diktuar nga interesat e ngushta, feudalët e mbledhur në kuvend u shprehën për bashkimin e tyre në luftë kundër pushtimit osman. Ideja e bashkimit të gjitha forcave politike, ushtarake dhe ekonomike të vendit në një front të përbashkët u konkretizua në mjaft vendime të tij. Më i rëndësishmi midis tyre ishte vendimi për krijimin e një besëlidhjeje të feudalëve shqiptarë, e që mori emrin “Lidhja e princave shqiptarë” (Lidhja e Lezhës).



Skënderbeut si organizator dhe udhëheqës i kryengritjes çlirimtare kundër regjimit të timareve, si dhe për shkak të pozitës së rëndësishme që kishte principata e Kastriotëve u zgjodh njëzëri kryetar i saj.

Barleti na jep informacion të pasur mbi Kuvendin e Lezhës dhe vendimet e tij. Ai thotë se Skënderbeu vendosi para së gjithash, se duhej hyrë në aleancë dhe në një farë besëlidhjeje të përhershme me princërit dhe sundimtarët fqinj. Dhe mandej, pasi përshkruan zhvillimin e punimeve të këtij kuvendi, thekson se të gjithë pasi ia kaluan gati si me dorë pushtetin, popujt, ushtritë, dhe pasi i besuan drejtimin suprem të të gjithë gjendjes dhe kujdesin e luftës, e zgjodhën kryetar dhe kapedan të tyre të vetëm. Skënderbeu, megjithëse kryetar dhe Komandant i Përgjithshëm, ishte në këtë kohë një “i parë midis të barabartëve”. Sidoqoftë, caktimi i një udhëheqësi të vetëm politik e ushtarak kishte një rëndësi të madhe dhe ishte një hap përpara në kapërcimin e përçarjes feudale. Të dhënat që na sjell Barleti konfirmohen dhe plotësohen me kujtimet e bujarit shqiptar Gjon Muzaka, bashkëkohës i Skënderbeut nga familja e Muzakajve.

Ai shkruan: “Pastaj këta, sundimtarët e Shqipërisë u mblodhën në Kuvend në Lezhë. Dikush shkoi vetë, dikush çoi mëkëmbës. Kështu që Skënderbeu i lartpërmendur u bë kryeprijës në Shqipëri, dhe secili dërgonte njerëz dhe të holla sipas sasisë që i takonte.



Po kështu edhe disa bij të atyre sundimtarëve luftonin nën drejtimin e tij edhe për të mësuar mjeshtërinë

e luftës edhe për të mbrojtur shtetet e veta. Duke qenë ai zotëri fort i rrahur në luftë dhe fatos, u zgjodh kryeprijës e secili i bindej”.

Vendimi për krijimin e ushtrisë

Pjesëmarrja në lidhje për çdo feudal garantonte të drejtën e mbrojtjes nga pushtuesi, si dhe detyrimin për të kontribuar në krijimin e ushtrisë dhe të mjeteve financiare të përbashkëta. Me këto detyrime lidhen dy vendime të rëndësishme të Kuvendit të Lezhës: vendimi për krijimin e një ushtrie të “Lidhjes së princave shqiptarë” si dhe sigurimin e mjeteve financiare për shpenzimet e luftës me forca të përbashkëta. Kuvendi i Lezhës vendosi të krijohet një ushtri shqiptare, e cila do të rekrutohej nga Skënderbeu në principatën e Kastriotëve si dhe nga feudalë të tjerë në zotërimet e tyre. Secili anëtar i lidhjes përcaktoi vullnetarisht numrin e ushtarëve me të cilët do të kontribuonte në krijimin e ushtrisë së përbashkët. Skënderbeu u zgjodh komandant i përgjithshëm i ushtrisë së Lidhjes, kurse komandantët e reparteve do të emëroheshin nga vetë bujarët. Për të përballuar shpenzimet e luftës, Kuvendi i Lezhës vendosi krijimin e një fondi të posaçëm në të holla, i cili do të sigurohej pjesërisht me kontributin e feudalëve shqiptarë dhe pjesërisht nga të ardhurat e kriporeve të Shën Kollit në veri të Durrësit, të cilat u përkisnin Kastriotëve. Mjetet financiare, si dhe ushtria do të administroheshin nga Skënderbeu, i cili jepte për çështjen e luftës çlirimtare kontributin kryesor midis bujarëve të tjerë në ushtarë dhe të holla. Skënderbeu u ngarkua nga Kuvendi i Lezhës me detyra të shumta drejtuese dhe

komanduese. Në këtë mënyrë ai merrte përgjegjësinë kryesore për zhvillimin e luftës. Nga pikëpamja strategjike “Lidhja e princave shqiptarë” përbënte aleancën politiko-ushtarake (besëlidhje) më të fuqishme midis bujarëve shqiptarë me njëri-tjetrin për mbrojtjen e zotërimeve të tyre feudale me forca të përbashkëta. Në zotërimet e tyre, bujarët shqiptarë pjesëmarrës ishin zotë të pavarur dhe mbajtës të çdo pushteti.

Skënderbeu komandanti ushtarak

Me gjithë rolin udhëheqës dhe komandues të Skënderbeut në “Lidhjen e princave shqiptarë”, pozita e tij drejtuese në vitet e para të ekzistencës së saj, nuk ishte ajo e një monarku, por e një drejtuesi ushtarak. Udhëheqja e tij përmbliidhet vetëm në organizimin e mbrojtjes së vendit, pa cënuar privilegjet e feudalëve të veçantë dhe pushtetin e tyre brenda zotërimeve të veta. Skënderbeu kishte të drejtë në raport me anëtarët e tjerë të lidhjes të thërriste kuvendin e princave shqiptarë sa herë ta shihte të nevojshme për interesat e mbrojtjes së vendit. Anëtarët e lidhjes ruanin të drejtën e largimit prej saj, kur ta shihnin të nevojshme. Skënderbeu si kryetar i lidhjes dhe lidhja nuk kishin të drejtë ta pengonin ose të merrnin masa kundër tij.

Në Lidhje bujarët feudalë ruajtën të drejtën të hynin në marrëdhënie ndërkombëtare në mënyrë të pavarur. Në vitet e mëvonshme një pjesë e mirë e princave shqiptarë përfunduan traktate ndërkombëtare me shtetet italianë, pavarësisht nga Skënderbeu dhe Lidhja. Gjergj Araniti lidhi traktat të veçantë me Alfonsin e Napolit (1451), dhe një tjetër me Venedikun. Kështu kanë vepruar edhe bujarët e tjerë. Lufta e përbashkët kundër Perandorisë Osmane dhe Venedikut bëri që subjekt i marrëdhënieve ndërkombëtare në vendimet të dalë në tërësi “Lidhja e princave shqiptarë” dhe jo ndonjë bujar i veçantë. Gjatë luftës me Venedikun më 1448 Skënderbeu, pas vdekjes së Lekë Zaharisë, e kërkoi qytetin e Danjës në emër të Lidhjes. Fitorja u arrit me forca të përbashkëta të feudalëve shqiptarë. Kurse Traktati i Paqes (4 tetor 1448) u përfundua duke qenë palë “Lidhje e princave shqiptarë”, e përfaqësuar nga Skënderbeu dhe Nikollë Dukagjini e Republika e Venedikut. Në historinë e Lidhjes së Lezhës ky është rasti i parë kur del në bllok njëkohësisht para dy armiqve të rrezikshëm, Perandorisë Osmane dhe Venedikut. Lidhja lufton dhe fiton për mbrojtjen e vendit dhe të tërësisë së tij territoriale, vepron me personalitet të plotë politik në marrëdhëniet ndërkombëtare.



VITI AKADEMIK 2020-2021

Në Akademinë e Forcave të Armatosura vijon sezoni i parë i provimeve për vitin akademik 2020-2021 me ciklin e parë të studenteve "Bachelor"

